

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës

John DeROSA*

* Kjo analizë është shkruar nga Prof. John DeRosa, në cilësinë e hulumtuesit jo rezident në fushën e politikave publike pranë Institutit GAP. Prof. DeRosa ka shërbyer mbi njëzet vite si ushtar, oficer dhe analist i mbrojtjes dhe dy herë ka shërbyer në Kosovë si pjesë e KFOR-it. Prof. DeRosa është Profesor i Asociuar në Universitetin e Maryland, ka kryer studimet themelore (BA) në fushën e ekonomisë dhe studimet post diplomike (MA) në Studimet Kombëtare të Sigurisë, në Universitetin Shtetëror të Kalifornisë. Aktualisht është duke studiuar marrëdhëniet civilo-ushtarake në shtetet e dala nga konflikti, në Shkollën për Studimin dhe Zgjidhjen e Konflikteve në Universitetin George Mason.

Shkurtesat

BPV	Bruto Produkti Vendor
DSH	Departamenti i Shtetit i SHBA-së
DM	Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së
FOS	Forcat e Operacioneve Speciale
FK	Forca e Kosovës
FS	Forcat Speciale
KSKB	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
MCU	Marrëdhëniet Civile Ushtarake
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së
PP	Partneriteti për Paqe
RBSS	Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë
RSM	Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	4
1. Hyrje.....	9
2. Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (RBSS) 2006	10
3. Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë (RSSS) 2013	11
4. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes.....	12
5. Metodologjia.....	13
6. Interesat Shtetërore.....	14
7. Mjedisi strategjik.....	16
8. Kërcënimet dhe mundësitë	22
9. Alternativat Strategjike	29
10. Bibliografia	44

Përmbledhje ekzekutive

Pas më shumë se dhjetë viteve të administrimit nga Kombet e Bashkuara, operacioneve të vazhdueshme ushtarake të Aleancës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) përmes misionit KFOR dhe në koordinim me institucionet Evropiane, Republika e Kosovës lindi si shtet i ri në vitin 2008. Para shpalljes së pavarësisë, Kombet e Bashkuara autorizuan në vitin 2006 një Rishikim të Brendshëm të Sektorit të Sigurisë (RBSS), me qëllim të ekzaminimit të sektorit të sigurisë dhe krijimit të një modeli mbi bazën e të cilit do të ndërtohej sektori i sigurisë në Kosovë. Pas RBSS, Kosova shpalli pavarësinë e vendit dhe në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZCN), krijoi strukturën e sigurisë në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës të Kombeve të Bashkuara për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, (Plani i Ahtisarit). Paralel me misionin paqeruajtës të NATO-s dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX, Kushtetuta e shtetit të ri përcaktoi qartë kompetencat e institucioneve vendore në fushën e zbatimit të ligjit, duke përfshirë sektorin e sigurisë, gjyqësinë, sigurinë publike, inteligjencën, reagimin ndaj emergjencave civile dhe kontrollin kufitar. Ligjet e reja të cilat u miratuan pas hyrjes së Kushtetutës në fuqi, krijuan kornizën ligjore për strukturimin e sektorit të sigurisë në përputhje me dispozitat e Planit të Ahtisarit, duke përfshirë edhe një dispozitë e cila parasheh “një rishikim të këtyre limiteve pas periudhës 5 vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji” (Kuvendi i Kosovës, 2008).

Këto dispozita përcaktojnë kornizën ligjore mbi bazën e së cilës Kosova për herë të parë si shtet i pavarur do të zhvilloj politikën e sigurisë shtetërore, e cila do të përfshij edhe një sërë rekomandimesh për ristrukturimin rrënjësor të arkitekturës së sektorit të sigurisë. Në përputhje me këto dispozita, Qeveria e Kosovës është duke përgatitur Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), me qëllim që të përcaktoj objektivat strategjike dhe politikat e Republikës së Kosovës në fushën sigurisë dhe të mbrojtjes (MFSK, 2012). Duke u nisur nga fakti që një shoqëri civile e informuar dhe e zëshme kontribuon në krijimin dhe ruajtjen e institucioneve të pavarura dhe demokratike, dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, Instituti GAP ka zhvilluar një analizë të pavarur mbi rishikimin strategjik të mbrojtjes.

Synimi kryesor i këtij rishikimi është nxitja e diskutimeve mbi vendimet që ndërliken me interesat vitale të Kosovës, mënyrën se si ato mund të mbrohen më së miri dhe resurset që janë të nevojshme në këtë drejtim. Ky dokument ofron një analizë të pavarur mbi atë se si do të duhej të duken forcat e armatosura të Kosovës, respektivisht një pasqyrim objektiv mbi interesat shtetërore vitale, kërcënimet

rajonale dhe zgjedhjet strategjike për mundësitë dhe kapacitetet e forcave të armatosura të Kosovës në të ardhmen.

Në këtë analizë, interesi shtetëror vital përkufizohet si një gjendje (situatë) e qëndrueshme, rrezikimi i së cilës cenon ekzistimin e Kosovës dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Strategjia e mbrojtjes duhet të dizajnohet në atë mënyrë që forcat e armatosura të Kosovës të jenë të mjaftueshme dhe të kenë kapacitetet adekuate për të siguruar dhe mbrojtur këto interesa. Gjatë zhvillimit të kësaj analize janë identifikuar këto interesa kombëtare:

- Pavarësia dhe integriteti territorial
- Kushtet që mundësojnë stabilitet ekonomik
- Konsolidimi i shtetit demokratik
- Siguria dhe stabiliteti i rajonit

Çështjet tjera të cilat janë parashtruar gjatë procesit të vlerësimit përfshijnë edhe atë se cilat janë kërcënimet kryesore ndaj interesave shtetërore? Në përgjithësi kërcënimet kryesore janë të natyrës politike-ekonomike, kriminale-terroriste dhe mjedisore. Nga aspekti politik, kërcënimi më i madh i sigurisë për Kosovën, mbetet pretendimi territorial i Serbisë ndaj Kosovës, i etabluar në kushtetutën e vendit. Gjendja e vështirë ekonomike vazhdon të jetë një faktor tjetër që kërcënon sigurinë në Kosovë. Gjithashtu krimi i organizuar ndërkombëtar, ekstremizmi i dhunshëm dhe kërcënimet e natyrës mjedisore mund të kenë pasoja të konsiderueshme në interesat shtetërore të Kosovës.

Një analizë e plotë e kushteve të mjedisit strategjik, interesave shtetërore, kërcënimeve dhe mundësive, krijon hapësirë për të rishikuar tërë arkitekturën e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë në Kosovë. Këto mundësi vijnë në formë të rekomandimeve për rishikimin e rolit dhe misionit, strukturës së sektorit të sigurisë dhe reformave në fushën e mbrojtjes. Për çdo qeveri, nuk ka asnjë gjë më prioritare se mbrojtja e sovranitetit të shtetit, qytetarëve dhe interesave kombëtare të sigurisë. **Andaj kjo analizë konkludon se roli kryesor i forcave të armatosura është të ruaj pavarësinë dhe integritetin territorial të shtetit, përmes zbulimit, zbrapsjes, parandalimit, dhe nëse është e nevojshme luftimit të kërcënimeve dhe agresionit ndaj shtetit.**

Në aspektin afatshkurtër, kushtet në mjedisin strategjik mund të mos jenë të favorshme që Kosova të ndërtoj një forcë ushtarake e gatshme për të kryer funksione dhe operacione, në nivelin e njëjtë me ushtritë e shteteve të perëndimit. **Andaj, në këtë analizë rekomandohet që forcat e armatosura duhet të jenë në gjendje të kryejnë me sukses**

funksonet në vijim: misionet luftarake, ruajtjen e sigurisë dhe mbështetjen e autoriteteve civile. Në kuadër të roleve dhe misioneve të shtjelluara më lartë, operacione tipike të forcave të armatosura do të mund të përfshinin: **mbrojtjen territoriale, mbështetjen civile, ndihmën humanitare, operacionet e sigurisë dhe operacionet paqësore.**

Kosova ka arritur një pikë kthese në zhvillimin dhe shfrytëzimin e forcave të armatosura. Në mënyrë që forcat e armatosura të jenë në gjendje të përballojnë sfidat e lartpërmendura, Qeveria duhet të reflektoj mbi rreziqet dhe mundësitë në aspektin afatshkurtër dhe afatgjatë, në mënyrë që të krijoj alternativa për strukturën e forcave të armatosura, si në kuptim të numrit (kapaciteteve) ashtu edhe të aftësive operacionale. Megjithatë, ky rishikim strategjik i mbrojtjes është i realizueshëm vetëm për ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive të FSK-së në aspektin afatshkurtër dhe afatmesëm, në mënyrë që të jetë e gatshme për të përballuar vetëm sulmet e armatosura nga jashtë. Kufizimet në resurse do ta vështirësojnë shumë modernizimin dhe transformimin e FSK-së në ushtrinë e ardhshme të Kosovës, gjë që kërkon rebalancimin e kapaciteteve aktuale të FSK-së.

Duke marrë parasysh që Kosova është një shtet i ri , çfarëdo analize që bëhet do të konstatoj që kapacitetet dhe aftësitë operacionale të FSK-së janë dukshëm më të vogla se ato të ushtrive të rajonit. Duke vlerësuar kërcënimet kryesore ndaj interesave shtetërore dhe duke bërë krahasime me forcat e armatosurat të shteteve të rajonit, kjo analizë rekomandon rritjen e forcave të armatosura si për nga kapaciteti ashtu edhe për aftësia operacionale në mënyrë që të mund të përmbushin mandatin e dhënë me Kushtetutë.

Propozimi për përbërjen e forcave të armatosura			
Forcat tokësore	Forcat rezervë	Njësitë kryesore të këmbërorisë	Njësitë kryesore të aviacionit
5,000	1,500	1 x Brigadë e Këmbërorisë 1 x Batalion i Forcave Speciale 1 x Batalion i Zbulimit 2 x Batalion i Këmbërorisë (Rezervë)	1 x Skuadrile e Helikopterëve

Sa i përket qasjes për rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të forcave të armatosura, në përgjithësi kjo do të mund të bëhet në tri faza:

1. Konsolidimi dhe riorganizimi;
2. Sigurimi i armëve dhe mjeteve mbështetëse luftarake
3. Zgjerimi i forcës rezervë

“Konsolidimi dhe Riorganizimi” parasheh që rolet dhe misionet për reagim ndaj emergjencave në nivel të vendit të transferohen tek ministritë apo institucionet tjera përkatëse. “Sigurimi i armëve dhe mjeteve mbështetëse luftarake” parasheh krijimin dhe avancimin e kapaciteteve dhe aftësive operationale të forcave të armatosura. Ndërsa, “Zgjerimi i Forcës Rezervë” është i përqendruar në trajnimin, pajisjen dhe menaxhimin e një force rezervë të aftë për dislokim në çdo zonë të Kosovës për të mbështetur autoritetet civile, dhe nëse është e nevojshme të zgjerohet dhe të mbështesë njësitë e rregullta ushtarake në misionet luftarake dhe të sigurisë.

Në mbështetje të interesave shtetërore, gjatë Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes është analizuar edhe zhvillimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve demokratike civilo-ushtarake. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe konsolidimi i shtetit, dhe në këtë drejtim Kosova duhet të vazhdoj trajektoren drejt përmirësimit të funksionimit të institucioneve, shoqërisë civile dhe forcave të armatosura, duke u bazuar gjithnjë në parimet demokratike. Për të siguruar avancimin e kontrollit demokratik dhe civil të forcave të armatosura, kjo analizë rekomandon:

- zhvillimi i mëtutjeshëm i sistemit të mbikëqyrjes parlamentare dhe gjyqësore,
- përfshirjen aktive të komisioneve parlamentare përgjegjëse për çështjet e sigurisë,
- përfshirjen e komisionit parlamentar në çështjet që ndërlidhen me aspektet financiare në fushën e mbrojtjes, si dhe mbikëqyrjen e kompensimit dhe ekzekutimit të buxhetit për mbrojtje

Për të promovuar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në çështjet që ndërlidhen me sigurinë, kjo analizë rekomandon:

- edukimi e publikut mbi çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes,
- lehtësimin e dialogut me shoqërinë civile për çështjet e politikave,
- promovimin e hulumtimeve në sferën e politikave të sigurisë,
- promovimin e transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve të sigurisë,

- monitorimin e zbatimit të reformave dhe krijimin e politikave të qëndrueshme të mbikëqyrjes, si dhe
- zhvillimin e kapitalit njerëzor që gëzon njohuri të avancuara dhe ekspertizë në sferën e mbrojtjes dhe çështjet e sigurisë.

Për të promovuar konsolidimin e shtetit, kjo analizë rekomandon:

- avancimi i mundësive për përfshirjen e zyrtarëve të forcës së sigurisë, zyrtarëve publik dhe të shoqërisë civile në programet e edukimit në fushën e studimeve strategjike të mbrojtjes

Dhe në fund, kjo analizë rekomandon që:

- Qeveria duhet të vazhdoj avancimin e programeve për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë brenda rajonit, si pjesë të përpjekjeve për përmbushjen e synimit për integritet Euro-Atlantike.

1. Hyrje

Pas më shumë se dhjetë viteve të administrimit nga Kombet e Bashkuara, operacioneve të vazhdueshme ushtarake të Aleancës Ushtarake Veri Atlantike (NATO) përmes misionit KFOR dhe në koordinim me institucionet Evropiane, Republika e Kosovës lindi si shtet i ri në vitin 2008. Para shpalljes së pavarësisë, Kombet e Bashkuara autorizuan në vitin 2006 një Rishikim të Brendshëm të Sektorit të Sigurisë (RBSS), me qëllim të ekzaminimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, respektivisht shërbimet e emergjencës civile, policisë, sistemit shëndetësor dhe sistemit ekonomik, me qëllim të krijimit të një modeli mbi bazën e të cilit do të ndërtohej sektori i sigurisë në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZCN), shteti i Kosovës krijoi strukturën e sigurisë në përputhje me propozimin gjithëpërfshirës të Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës, të njohur si Plani i Ahtisarit (KS i OKB, 2007).

Kushtetuta e shtetit të ri përcaktoi qartë kompetencat e institucioneve vendore në fushën e zbatimit të ligjit, duke përfshirë sektorin e sigurisë, gjyqësisë, sigurisë publike, inteligjencës, reagimit ndaj emergjencave civile dhe kontrollin kufitar, ndërkohë që për disa nga këto fusha, kompetencat do të ndahen me misionin paqeruajtës të NATO-s dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, EULEX (Qehaja, Kosumi, Qehaja, & Bekaj, 2012). Ligjet e reja të cilat u miratuan pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, krijuan kornizën ligjore për strukturimin e sektorit të sigurisë në përputhje me dispozitat e Planit të Ahtisarit, duke përfshirë edhe një dispozitë e cila parasheh “një rishikim të këtyre limiteve pas periudhës 5 vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji” (Kuvendi i Kosovës, 2008).

Në përputhje me këto dispozita, Qeveria e Kosovës është duke përgatitur Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), me qëllim që të përcaktoj objektivat strategjike dhe politikat e Republikës së Kosovës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes (MFSK, 2012).

Duke u nisur nga fakti që një shoqëri civile e informuar dhe e zëshme kontribuon në krijimin dhe ruajtjen e institucioneve të pavarura dhe demokratike, dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, Instituti GAP ka zhvilluar një analizë të pavarur mbi rishikimin strategjik të mbrojtjes. Për më tepër, ky raport tregon edhe interesimin dhe përkushtimin për të qenë të përfshirë në diskursin publik mbi çështjet që ndërlidhen me sektorin e mbrojtjes në Kosovë.

Ky dokument është përgatitur duke shfrytëzuar hulumtimet dhe analizat e hapura si: të dhënat e publikuara nga Qeveria, raportimet

nga mediat, intervistat me ekspertë të Qeverisë dhe ekspertë të pavarur të kësaj fushe, si dhe raporteve dhe publikimeve tjera nga institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Ky dokument shpalos të gjeturat dhe rekomandimet e dalura nga analiza, e që kanë për synim të mbështesin përpjekjet për ndërtimin e një sektori të sigurisë efektiv dhe kredibil, si një faktor me rëndësi kritike jo vetëm për të ardhmen e Kosovës, por dhe për stabilitetin në tërë Ballkanin Perëndimor.

2. Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë (RBSS) 2006

Reforma e sektorit të sigurisë në Kosovë paraqet një rast unik në Ballkanin Perëndimor, duke marrë parasysh faktin që infrastruktura bazë e këtij sektori ishte shkatërruar gjatë konflikteve të viteve 90-të (Bernabéu, 2007). Menjëherë pas përfundimit të luftës së vitit 1999 në Kosovë, përgjegjësitë në fushën e sigurisë u morën nga forcat e sigurisë së NATO-s (KFOR), të cilat si pjesë e planit për çarmatosje, demobilizim dhe riintegrim, transformuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në Trupat Mbrotjtëse të Kosovës (TMK), si institucion për menaxhimin e emergjencave civile. (Qehaja, et al., 2012). Duke u vendosur nën përgjegjësinë e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara (PSSP) dhe nën mbikëqyrjen e KFOR-it, TMK u ngarkua me misionin për të “ofruar ndihmë për zonat e rrezikuara, për të zhvilluar operacione të kërkimit dhe shpëtimit, për të ofruar ndihmë humanitare në zonat e izoluara, për të ndihmuar në pastrimin e fushave të minuara, dhe për të kontribuar në ndërtimin e infrastrukturës dhe komuniteteve” (UNMIK, 1999).

Në vitin 2005, përgjegjësia për sigurinë në Kosovë, respektivisht krijimi i një mjedisi të sigurt dhe ofrimit të sigurisë publike i takonte në tërësi KFOR-it, ndërkohë që TMK ishte përgjegjëse për të ofruar shërbime në raste të emergjencave civile.¹ Në këto rrethana, PSSP inicioi rishikimi e brendshëm të sektorit të sigurisë, paralel me negociatat për përcaktimin e statusit final të Kosovës (UNDP, 2006). Dokumenti mbi rishikimin e sektorit të sigurisë së brendshme në

¹ Në kuadër të detyrave të KFOR-it përfshihej edhe ndihma për kthimin e personave të zhvendosur apo refugjatëve, rindërtimit dhe pastrimin e minave, ndihmën mjekësore, sigurinë dhe rendin publik, sigurinë e minoriteteve etnike, mbrojtjen e objekteve fetare, sigurimin e kufirit, ndalimin e kontrbandimit të armëve, implementimin e programit të amnestisë për armët, municionin dhe eksplozivët, shkatërrimin e armëve dhe asistencën për ndërtimin e institucioneve civile, rendi dhe ligji, sistemit gjyqësor, procesi zgjedhor dhe aspekte të tjera të jetës politike, sociale dhe ekonomike të vendit.

Kosovë u publikua në vitin 2006, me synimin për të ofruar një kornizë për sektorin e sigurisë në Kosovë “të dizajnuar për të ndihmuar Qeverinë e ardhshme të Kosovës në përballimin e rreziqeve të cilat janë identifikuar nga qytetarët, gjatë procesit të vlerësimit të rreziqeve, në kuadër të rishikimit të brendshëm të sektorit të sigurisë (UNDP, 2006). Në këtë dokument konkludohet se duke marrë parasysh zhvillimet rreth përcaktimit të statusit final të Kosovës, dhe si përgjigje ndaj vlerësimit për kërcënimet e mundshme, është e domosdoshme që të zhvillohet arkitektura për ndërtimin e sektorit të sigurisë mbi parimet e kontrollit civil dhe demokratik. Gjithashtu, u propozua që: kontrolli ekzekutiv mbi sektorin e sigurisë të bëhej përmes Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, agjensioneve të sigurisë ku përfshihen: Forca Mbrojtëse e Kosovës, Shërbimi Policor i Kosovës, Shërbimi i Sigurisë dhe Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave, ndërkohë që mbikëqyrja legjislative të mbetet përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës dhe komisioneve përkatëse për siguri dhe mbrojtje (UNDP, 2006).

3. Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë (RSSS) 2013

Nga viti 2006 kur është bërë rishikimi i brendshëm i sektorit të sigurisë, në Kosovë janë shënuar ndryshime të mëdha politike, si rezultat i të cilave arkitektura e sektorit të sigurisë është transformuar. Me 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës ka shpallur pavarësinë e vendit, duke shpalosur vizionin për ndërtimin e një shteti demokratik, multietnik dhe prosperues. Kushtetuta e shtetit të ri përcakton kompetencat e Qeverisë në fushën e zbatimit të ligjit, sigurisë, drejtësisë, sigurisë publike, inteligjencës, reagimin ndaj situatave emergjente dhe kontrollin e kufirit brenda territorit të vendit. (Qehaja, et al., 2012). Ligjet e miratuara pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës përcaktuan strukturën e sektorit të sigurisë sipas kushteve të parapara në Planin e Ahtisarit, të cilat në masë të madhe u ndikuan nga Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë i realizuar në vitin 2006, e që parashihte shpërbërjen e TMK-së dhe krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si forcë profesionale me armatim të lehtë e përgatitur për të kryer funksione të sigurisë të cilat nuk mund të kryhen nga shërbimi policor apo institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e ligjit.² Ligjet që rregullojnë sektorin e

² Misioni i FSK-së është që të kryej operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë vendit, operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës, si dhe t'i ndihmoj autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera.

sigurisë parashohin “rishikimin e plotë të këtyre kufizimeve, por jo më herët se pesë vite nga koha e hyrjes së ligjeve në fuqi” (Ligji mbi FSK-në, 2008). Këto dispozita përcaktojnë kornizën ligjore mbi bazën e së cilës Kosova për herë të parë si shtet i pavarur do të zhvilloj politikën e sigurisë kombëtare e cila do të përfshij edhe një sërë rekomandimesh për ristrukturimin rrënjësor të arkitekturës së sektorit të sigurisë.

4. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

Për të ndihmuar Qeverinë dhe shoqërinë civile që të arrijnë konsensus politik rreth sfidave dhe prioriteteve, GAP ka përgatitur këtë Rishikim Strategjik të Mbrojtjes përmes të cilit vlerësohet interesi shtetëror dhe nevojat e mbrojtjes, dhe shqyrtohen opsionet për përshtatjen e arkitekturës së sektorit të sigurisë së Kosovës në raport me zhvillimet e reja strategjike. Synimi kryesor i këtij rishikimi është nxitja e diskutimeve mbi vendimet që ndërlidhen me interesat vitale të Kosovës, mënyrën se si ato mund të mbrohen më së miri dhe resurset që janë të nevojshme në këtë drejtim. Ky dokument ofron një analizë të pavarur mbi atë se si do të duken forcat e armatosura të Kosovës, dhe synon të plotësoj debatin që ndërlidhet me rishikimin strategjik të sektorit të sigurisë, pa dashur ta zëvendësoj atë. Gjithashtu, ky raport nuk synon të zëvendësoj raportin e Qeverisë mbi Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë, por përkundrazi ofron një pasqyrim objektiv mbi interesat kombëtare vitale, kërcënimet rajonale dhe zgjedhjet strategjike për mundësitë dhe kapacitetet e forcave të armatosura të Kosovës në të ardhmen.

Ky rishikim strategjik i mbrojtjes paraqet një mundësi për të forcuar legjitimitetin e sektorit të sigurisë dhe për të përmirësuar transparencën në proceset që drejtohen nga Qeveria. Duke ofruar hulumtime dhe analiza profesionale nga një institucion i pavarur për politikat publike, qëllimi kryesor i kësaj analize është të kontribuoj në përpjekjet për të hartuar politika publike të mira të cilat promovojnë zgjidhje efektive në vendosjen e paqes dhe stabilitetit.

Këtu përfshihen edhe operacionet e kërkim shpëtimit, mënjanimi i mjeteve shpërthyesë, kontrolli dhe pastrimi i materieve të rrezikshme; zjarrfikjen, si dhe detyrat tjera me qëllim ndihmën humanitare.

5. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për zhvillimin e kësaj analize mbështetet në qasjen e bazuar në interesin kombëtar kundrejt sigurisë shtetërore apo kombëtare. Interesat kombëtare përkufizohen si nevoja dhe aspirata të perceptuara të një vendi në raport me mjedisin strategjik. Interes kombëtar konsiderohet çdo çështje e cila ka potencial për të ndikuar drejtpërdrejt në përpjekjet për të realizuar synimet e vendit. Interesat kombëtare paraqesin fokusin e veprimeve dhe njëkohësisht bazën apo pikën fillestare për hartimin e politikave dhe strategjive për sigurinë kombëtare. Metodologjia e përdorur parasheh hapat specifik për përcaktimin e interesave kombëtare: përcaktimin e interesave kombëtare në kuptim të vlerave kombëtare dhe mjedisit strategjik, identifikimin dhe vlerësimin e sfidave (kërcënimeve dhe mundësive) ndaj këtyre interesave, krahasimin e sfidave në raport me strategjitë dhe politikat aktuale, dhe në bazë të këtij vlerësimi, hartimin e rekomandimeve të politikave për mbrojtje ndaj këtyre kërcënimeve duke shfrytëzuar mundësitë në dispozicion. (Yarger&Barber, 1997).

Gjatë procesit të hartimit të analizës, është shqyrtuar literaturë e gjerë nga burimet primare dhe sekondare që ndërlidhen me çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes në Kosovë. Studimi ka shfrytëzuar të dhëna nga qindra studime dhe raporte të Qeverisë, sferës akademike dhe komunitetit të instituteve të specializuara (think-tanks), i është referuar shumë studimeve dhe publikimeve të natyrës akademike, si dhe strategjive, doktrinave dhe koncepteve ushtarake. Arsyeja kryesore e shfrytëzimit të literaturës së lartpërmendur ka qenë kuptimi i: mjedisit strategjik aktual, kërcënimeve, mundësive dhe kapaciteteve të institucioneve të sigurisë të krijuara rishtazi në Kosovë. Përveç shqyrtimit të literaturës relevante, hulumtuesit kanë zhvilluar edhe intervista me ekspertë të fushës së sigurisë.

Burimet e shfrytëzuara për zhvillimin e analizës janë kryesisht të natyrës kualitative, duke përfshirë: ligjet në fuqi, rregulloret, fjalimet, komunikatat për media, traktatet, buxhetin e shtetit, raportet e publikuara nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, artikujt akademik, artikujt e gazetave, intervistat me ekspertët e fushës. Gjithashtu, hulumtuesit kanë përdorur edhe metodën kuantitative. Përveç kësaj, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, ofron një analizë mbi hipotezat dhe dobitë e parapara me vlerësimin gjithëpërfshirës të kërcënimeve, gjatë Rishikimit të Brendshëm të Sektorit të Sigurisë ë 2006 (Taylor&Boggs, 2011).

6. Interesat Shtetërore

Në këtë analizë, interesi shtetëror vital përkufizohet si një gjendje (situatë) e qëndrueshme, rrezikimi i së cilës cenon ekzistimin e Kosovës dhe mirëqenien e banorëve të saj. Interesat shtetërore apo kombëtare vitale paraqesin themelin mbi të cilin duhet të zhvillohen diskutimet rreth çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen. Qëllimi i përdorimit të qasjes së bazuar në interes shtetëror është qartësimi i interesave kombëtare vitale, të cilat do të përcaktojnë vendimet strategjike mbi ndërtimin e sektorit të sigurisë kombëtare dhe definimit të përgjegjësive, dhe njëkohësisht të ndihmojnë në hartimin e strategjisë kombëtare të sigurisë. Qasja e bazuar në interesin kombëtar kundrejt sigurisë kombëtare në Kosovë nuk do të zgjidh problemin e politikave të sigurisë, por megjithatë mund të ndikoj në përqendrimin e debatit në çështjet kryesore, të cilat trajtohen në këtë analizë.

Pyetja e parë që parashtrohet gjatë këtij vlerësimi është: cilat janë interesat kombëtare afatgjate? Interesat kombëtare afatgjate për Republikën e Kosovës përbëhen nga disa synime dhe vlera themelore të qytetarëve të Kosovës, si dhe nevojat politike, ekonomike dhe sociale të domosdoshme për prosperitetin e individëve, shoqërisë dhe shtetit. Këto interesa duhet pasur parasysh gjatë dizajnit të strategjisë së mbrojtjes, ndërkohë që forcat e armatosura të Kosovës duhet të jenë të mjaftueshme dhe të kenë kapacitet adekuat për të siguruar dhe mbrojtur ato.

Gjatë analizës janë identifikuar këto interesa kombëtare:

- Pavarësia dhe integriteti territorial
- Kushtet që mundësojnë stabilitet ekonomik
- Konsolidimi i shtetit demokratik
- Siguria dhe stabiliteti i rajonit

Pavarësia dhe integriteti territorial: Me gjithë pluralizmin parlamentar që do të vështirësonte arritjen e konsensusit rreth interesave kombëtare, pavarësia dhe integriteti territorial paraqet një element rreth të cilit të gjithë pajtohen unanimisht. Ky element theksohet qartë si një nga parimet e para në deklaratën e pavarësisë dhe në dy nenet e para të Kushtetutës. Për më tepër mund të thuhet se nga interesat e identifikuara më lartë, ky mbetet interesi më vital kombëtar i cili krijon kushtet për të ruajtur dhe forcuar mbijetesën dhe mirëqenien si shtet i lirë dhe i sigurt. Andaj, është me interes primar që vendi të mbrohet nga ndërhyrjet në punët e brendshme dhe të parandalohen kërcënimet për përdorimin e forcës kundër tërësisë territoriale të Kosovës.

Kushtet që mundësojnë stabilitet ekonomik: Një shtet i qëndrueshëm ekonomikisht ka ndikim të konsiderueshëm në mirëqenien e qytetarëve të tij dhe rritë mundësitë për të siguruar një nivel më të mirë të jetës. Mundësitë dhe rritja ekonomike u ofrojnë qytetarëve një rol aktiv në ruajtjen e paqes, ndërkohë që dështimi i një shteti për të përmirësuar performancën ekonomike rrezikon qëndrueshmërinë e paqes (Collier, 2007). Andaj, ky interes gjithashtu ndërlidhet me kapacitetet dhe mundësitë e Kosovës që të konsolidohet si shtet demokratik.

Konsolidimi i shtetit demokratik: Ekzistojnë pesë kushte themelore për konsolidimin e vendeve demokratike: shoqëria civile e lirë dhe aktive, shoqëria politike autonome, sundimi i ligjit që mbron të drejtat e njeriut, burokracia e shtetit dhe shoqëria ekonomike e institucionalizuar (Linz & Stepan, 1996). Shoqëria civile konsiderohet e lirë dhe aktive atëherë kur “polisi” organizohet në grupe, lëvizje dhe asociacione të cilat aritukulojnë vlera dhe interesa specifike. Shoqëria politike autonome nënkupton mbajtjen e zgjedhjeve kompetitive, të lira dhe gjithëpërfshirëse, e që nga shoqëria civile shihen si legjitime. Sa i përket sundimit të ligjit, të gjithë akterët e rëndësishëm mbahen përgjegjës para ligjit. Në anën tjetër, një burokraci funksionale është me rëndësi esenciale për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve, ruajtjen efikase të monopolit në përdorimin legjitim të forcës dhe mbledhjen e taksave për të paguar zyrtarët publik dhe shërbimet themelore. Synimi strategjik i Kosovës për integritet Euro-Atlantike mund të realizohet vetëm përmes përmbushjes së këtyre kushteve, ndërkohë që Komisioni Evropian në raportet periodike për Kosovën shpalos progresin e vendit drejt përmbushjes së këtyre kushteve (KE, 2012).

Siguria dhe stabiliteti i rajonit: Aktet juridike mbi të cilat është themeluar shteti dhe politikat koherente deklarative, tregojnë se Kosova ka treguar përkushtim për ndërtimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve me shtetet fqinje, si faktor paqeje dhe stabiliteti (Jahjaga, 2013). Siguria dhe prosperiteti i shtetit të Kosovës ndërlidhet pashmangshëm me stabilitetin e rajonit, e që mund të arrihet përmes mbështetjes së dyanshme mes shteteve të rajonit dhe krijimit të një mjedisi të sigurt për të gjithë. Forcimi i lidhjeve të cilat nxisin veprimet kolektive për konfrontimin me sfidat e përbashkëta të shteteve, rezulton me zvogëlimin e mundësive për vënien në zbatim të forcës ushtarake shtrënguese si opsion, dhe rritë mundësitë për vënien në zbatim të opsioneve të tjera që kanë për qëllim ruajtjen e stabilitetit në rajon, si ato të natyrës ekonomike (Keohane & Nye, 1977).

7. Mjedisi strategjik

Mjedisi strategjik përbëhet nga kushtet, kërcënimet dhe mundësitë të cilat ndikojnë në suksesin e një shteti. Sfidat ndaj interesave kombëtare të Kosovës paraqiten në forma të ndryshme, ndër të cilat dominojnë ato të natyrës gjeopolitike, përbrenda mjedisit strategjik. Në kuadër të mjedisit strategjik fillimisht duhet të identifikohet konteksti dhe kushtet specifike.

Nga viti 2006 kur është bërë Rishikimi i Brendshëm i Sektorit të Sigurisë, në Kosovë janë shënuar ndryshime të mëdha politike, si rezultat i të cilave arkitektura e sektorit të sigurisë është transformuar. Ndryshimi kryesor në këtë drejtim është shpallja e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur. Si pjesë të deklaratës së pavarësisë, në vitin 2008, Kosova është zotuar se do të përmbush të gjitha obligimet të cilat dalin nga Plani i Ahtisarit dhe ka mirëpritur mbikëqyrjen ndërkombëtare për një periudhë të caktuar (U.S. DSh, n.d.). Pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës ka përfunduar në Shtator të vitit 2012, ndërsa gjatë kësaj periudhe Kosova ka vendosur themelet e një Republike demokratike përfaqësuese, ka nisur përfaqësimin në politikën e jashtme dhe ka përmbyllur tranzicionin e institucionit përgjegjës për emergjencat civile TMK, në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Deri në muajin Mars të vitit 2013, 99 shtete e kanë njohur shtetin e pavarur të Kosovës, prej të cilave 22 nga 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, dhe 24 nga 28 vende anëtare të NATO-s, si dhe të gjitha shtetet fqinje (me përjashtim të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovines). Me gjithë progresin e arritur, forcat e sigurisë së NATO-s, KFOR, vazhdojnë të zbatojnë mandatin për ruajtjen e sigurisë, nën rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, ndërsa Bashkimi Evropian vazhdon misionin e sundimit të ligjit, EULEX, në mbështetje të sektorit të drejtësisë dhe agjencioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Në kuadër të këtij konteksti, kushtet gjeopolitike në të cilat ekziston Kosova vazhdojnë të jenë të paqëndrueshme. Me gjithë faktin që njihet nga shumica e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe NATO-s, Kosova mbetet e përjashtuar nga anëtarësia e plotë në këto institucione ndërkombëtare. Gjatë negociatave të vitit 2012, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje rreth kushteve nën të cilat Kosova mund të përfaqësohet në takimet me karakter ndërkombëtar (Brunwasser, 2012).³ Deri në atë kohë, në

³ Marrëveshja për përfaqësimin e Kosovës ndërkombëtarisht, parasheh vendosjen e një fusnote "Kosovo*." Teksti i fusnotës është si vijon: "Ky emërtim është pa paragjykim ndaj pozicionit mbi statusin dhe është një linjë me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe mendimin e GjND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës".

forumet ndërkombëtare Kosovën e përfaqësonte UNMIK-u. Tani, në kohën kur po realizohet ky vlerësim, BE-ja është duke lehtësuar dialogun që ka për synim normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë.⁴ Në këtë situatë, Kosova po vazhdon të avancoj dukshëm në arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, ku mund të veçohet: studimi i fizibilitetit me Komisionin Evropian i cili ndihmon Kosovën drejt negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe krijimit të marrëdhënieve kontraktuale në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, anëtarësimi në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Këshillin Rajonal për Bashkëpunim, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Kartën SHBA-Adriatik (Jahjaga, 2013; KE, 2012).⁵

Midis këtyre sfidave dhe mundësive, Kosova qëndron virtualisht përbrenda një lufte më të gjerë në mes të “perëndimit” dhe lindjes”. Në perëndim, vendet e kuinit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar janë fuqishëm të përkushtuara në mbështetje të Kosovës si shtet i pavarur, sovran dhe multietnik. Ndërsa në lindje, disa analistë mendojnë se Rusia dhe Kina haptazi kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, dhe në vazhdimësi përdorin veton në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të penguar pjesëmarrjen e Kosovës në skenën politike botërore, me pretekstin se pavarësia e Kosovës është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe minon parimet e Kombeve të Bashkuara, por në fakt të dy vendet përballen me lëvizje separatiste, andaj çdo lëvizje drejt njohjes së Kosovës dëmton politikat e tyre kombëtare (Hoxha, 2012; Friedman, 2007). Edhe në nivel rajonal ekziston “Perëndimi” dhe “Lindja”, sado që në shkalë më të vogël. Turqia dhe Greqia, të dyja anëtare të NATO-s që kontribuojnë me kontingjentet e tyre në KFOR, qëndrojnë në pole të kundërta sa i përket njohjes së shtetit të Kosovës. Një zyrtar i lartë i mbrojtjes në Turqi ka deklaruar se “Turqia vazhdon të mbështesë Kosovën në të gjithë sektorët. “Kosova është shtet i pavarur dhe i barabartë me të gjitha shtetet tjera të Ballkanit”, ndërkohë që zyrtarët e lartë të shtetit Grek ende mbajnë qëndrim refuzues ndaj njohjes së Kosovës (RTK, 2013; B92, 2013). Në këtë situatë, pretendimet territoriale të Serbisë ndaj Kosovës të etabluara në Kushtetutën e Serbisë dhe anëtarësimi i

⁴ Më 19 Prill, 2013, BE arriti të ndërmjetësoj “Marrëveshjen e parë mbi parimet bazë për normalizimin e marrëdhënieve” në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në fazën e zbatimit, ndër të tjera kjo marrëveshje do të adresoj edhe çështjet që ndërlidhen me sektorin e sigurisë, e veçanërisht institucionet paralele Serbe, të cilat rrezikojnë integritetin e Kosovës.

⁵ Më 28 Qershor, 2013, shtetet anëtare të BE-së, autorizuan Komisionin Evropian që të nisë negociatat me Kosovës në lidhje me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.

Kosovës në institucionet kryesore ndërkombëtare, mbesin dy nga sfidat më të rëndësishme gjeopolitike (KE, 2012).

Dimensioni ushtarak paraqet një sfidë shumë të rëndësishme për Kosovën. Sot, rreth 5,000 trupa të NATO-s nga 30 shtete vazhdojnë të jenë të stacionuara në Kosovë, në kuadër të operacionit paqeruajtës të KFOR-it. Në vitin 2009, NATO njoftoi se ka për qëllim të zvogëloj numrin e trupave të KFOR-it në rreth 2,500, sipas planit i cili parasheh zvogëlimin e trupave në raport me konceptin e mbajtjes së “forcës prezente të domosdoshme”, i cili u aplikua edhe në Bosnje dhe Hercegovinë (JFCHQ, 2011; KFOR, 2005; SFOR, 2004).⁶

Për fat të keq, dhuna e vitit 2011 tregoi domosdoshmërinë e dislokimit të batalionit të Forcave Operacionale Rezervë të NATO-s për të krijuar një mjedis të sigurt, dhe njëkohësisht shtyrjen e planit të tranzicionit për një fazë të mëvonshme. Vlerësimet e fundit sugjerojnë që nga KFOR-i duhet kërkuar të ofroj një mjedis të sigurt për lokacione të caktuara, kontrollin e trazirave dhe menaxhimin e kufijve, së paku derisa të normalizohen marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës (Clapper, 2012). Përveç KFOR-it, edhe EULEX-i operon në sektorin e sigurisë me rreth 1.700 ekspertë gjyqësor dhe të së drejtës ndërkombëtare, të cilët mbështesin zhvillimin dhe forcimin e sektorit të drejtësisë, shërbimit policor dhe shërbimit doganor. Prezenca e këtyre forcave ndërkombëtare në sektorin e sigurisë paraqesin mundësi por edhe sfida për shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës.

Në krahasim me arkitekturën e forcave të armatosura të vendeve fqinje, Forcat e Sigurisë në Kosovë qëndrojnë dobët (shikoni tabelën 1: Balanci ushtarak në Ballkanin Perëndimor). Në njërin anë, ushtria e Serbisë është dukshëm më e madhe në krahasim me Forcën e Sigurisë së Kosovës, si për nga kapaciteti ashtu edhe për nga mundësitë. Në anën tjetër, FSK deri diku mund të krahasohet me kapacitetet, por jo edhe mundësitë e ushtrisë së Malit të Zi, një vend ky i cili ka një popullsi më të vogël se gjysma e popullsisë në Kosovë, dhe më një mesatare prej 3.76 ushtarëve në shërbim për 1000 banorë. Një kalkulim i forcave të armatosura të FSK dhe KFOR së bashku, në

⁶ Në vitin 2010, KFOR-i gradualisht filloi të zvogëloj numrin e ushtarëve si dhe konceptin e operacioneve duke lëvizur në drejtim të “ruajtjes së forcës së domosdoshme”. Ky koncept parasheh operacione të drejtuara nga grupe të vogla të ushtarëve të shpërndarë në rajone të ndryshme si “ekipe ndërlidhëse monitoruese” (LMT), të cilat janë përgjegjëse për të monitoruar situatën sociale, politike dhe ekonomike në komunën ku janë të dislokuar. KFOR ka vënë në zbatim konceptin e LMT-ve, që nga viti 2005. LMT-të janë një version i modifikuar i konceptit “Ekipet ndërlidhëse dhe vëzhguese”, të aplikuar nga SFOR në Bosnje dhe Hercegovinë.

raport me popullsinë në Kosovë del të jetë 2.7 ushtarë për 1000 qytetarë, ndërsa nëse kalkulohet vetëm FSK atëherë numri i ushtarëve për 1000 banorë zvogëlohet në 1.3. Është me rëndësi të theksohet që numri dhe struktura e forcave të armatosura të shteteve të Ballkanit Perëndimor dallon nga njëri vend në tjetrin, dhe kjo në masë të madhe përcaktohen nga faktorët historik dhe kushtet gjeografike, respektivisht nga mbetjet e forcave të armatosura të ish-Jugosllavisë dhe kërkesat për forcat detare dhe ajrore. Andaj, nëse krahasohen vetëm kapaciteti i trupave tokësore, zbrazëtira në nivel rajonal zvogëlohet në 2.76 ushtarë për 1000 banorë, në krahasim me 2.7 për 1000 banorë në Kosovë (FSK dhe KFOR bashkë) dhe 1.35 ushtarë për 1000 banorë (vetëm FSK). (Instituti Ndërkombëtar për Studime të Strategjike - INSS, 2013).

TABELA 1: Balanci ushtarak në Ballkanin Perëndimor

	Popullsia	Forcat aktive	Forcat rezervë	Forcat tokësore	Forcat ajrore	Njësitë kryesore tokësore	Njësitë kryesore ajrore
Serbia	7,276,604	28,150	50,150	13,250	5,100	4 x Brigada Motorike 8 x Njësi të Këmbësisë BDE (Rezervë)	1 x Njësi e avionëve sulmues 1 x Skuadrile e avionëve transportues 1 x Skuadrile e helikopterëve sulmues 2 x Skuadrile e helikopterëve transportues
Kroacia	4,480,043	18,600	21,000	11,400	3,500	1 x Brigadë të Blinduara 1 x Brigadë Motorike 3 x Regjimenti i Gardës 1 x Batalion të Forcave Speciale	2 x Skuadrile e avionëve sulmues 1 x Skuadrile e avionëve transportues 1 x Skuadrile e avionëve zjarrfikës 1 x Skuadrile e helikopterëve transportues
Shqipëria	3,002,859	14,250		8,150		1 x Brigadë të Këmbësisë 1 x Regjiment i Komandove	1 x Skuadrile e helikopterëve transportues
Bosnja dhe Hercegovina	3,879,296	10,550		9,200	850	3 x Brigadë të Këmbësisë	3 x Skuadrile e Helikopterëve
Maqedonia	2,082,370	8,000	4,850			2 x Korpuse të	1 x Skuadrile e

						Shtabit 2 x Brigada Motorike BDE 1 x Brigadë Motorike e Tankseve 2 x Batalion të Forcave Speciale	helikopterëve sulmues 1 x Skuadrile e helikopterëve transportues
Sllovenia	1,996,617	7,600	1,700	7,600 (Aktiv)	100 (Rezervë)	3 x Batalion Motorik i KëmbëSORISË 1 x Njësi e Forcave Speciale 1 x Batalion i zbulimit	1 x Skuadrile e avionëve sulmues 1 x Skuadrile e helikopterëve transportues
Kosova (pa KFOR)	1,847,708	2,500	800	2,500	0	1 x Brigadë e këmbëSORISË	
Mali i Zi	657,394	2,080		1,500	230	1 x Brigadë Motorike 1 x Brigadë e Forcave Speciale 1 x Kompani e Zbulimit	1 x Skuadrile e Helikopterëve
Referenca: Instituti Ndërkombëtar për Studime Strategjike (2013). Balanci Ushtarak. Londër, Mbretëria e Bashkuar.113:1, 543-556.							

8. Kërcënimet dhe mundësitë

Pyetjet tjera të cilat janë parashtruar gjatë procesit të vlerësimit përfshijnë edhe atë se: cilat janë kërcënimet kryesore ndaj interesave shtetërore gjatë pesëmbëdhjetë apo njëzet viteve të ardhshme, dhe cilat janë mundësitë për të avancuar interesat shtetëror? Në përgjithësi kërcënimet kryesore janë të natyrës politike-ekonomike, kriminale-terroriste dhe mjedisore. Secili nga këto kërcënime përmban në vete një sërë elementesh të cilat në kalkulimin e rrezikut dallojnë për nga probabiliteti për të ndodhur apo për nga pasojat eventuale. Me qëllim të rritjes së vigjilencës, ky raport thekson rrezikun ndaj sigurisë së vendit që ndërlidhet me riciklimin e kërcënimeve globale e rajonale të pranuar si konvencionale, ndërkohë që përqendron analizën në kërcënimet e drejtpërdrejta për interesat vitale shtetërore të Kosovës.⁷

Ashtu siç ishte potencuar edhe në Rishikimin e Brendshëm të Sektorit të Sigurisë në vitin 2006, gjendja aktuale ekonomike vazhdon të jetë një element kritik që kërcënon sigurinë në Kosovë. Në vitin 2006 u konstatua se shkalla e lartë e papunësisë dhe varfërisë si dhe zhvillimi i dobët ekonomik ndikonin në krijimin e një ndjenje të pasigurisë në Kosovë. Zhvillimi i pamjaftueshëm dhe sistemi ekonomik jo i integruar, bënë që Kosova të izolohej edhe më shumë pas krizës financiare globale të vitit 2008. Edhe pse gjatë tri viteve të fundit Kosova ka shënuar rritje vjetore të GDP për 4%, Bashkimi Evropian vlerëson që shkalla e papunësisë kalon 40%, ndërsa në mesin e të rinjve kjo shkon në mbi 70%, shkalla vjetore e inflacionit 7.4% dhe paga mesatare në vend është 368 € (KE, 2012). Andaj, ekonomia e dobët do të vazhdojë të jetë kërcënim i përhershëm për sigurinë e Kosovës në të ardhmen e afërt, duke kërcënuar kështu dy nga interesat shtetërore vitale, respektivisht “krijimin e kushteve që mundësojnë stabilitet ekonomik” dhe “konsolidimin e shtetit demokratik”.

⁷ De France & Witney (2013) pohojnë se kërcënimet e pranueshme si konvencionale përfshijnë: konfliktet rajonale, shumëfishimin e popullsisë, terrorizmin, sigurinë financiare, sigurinë kompjuterike, sigurinë e sektorit të sigurisë, ndryshimet klimatike, epidemitë, katastrofat natyrore dhe industrial, krimin e organizuar, trafikun e drogës dhe migrimin.

Nga aspekti politik, kërcënimi më i madh i sigurisë për Kosovën, mbetet pretendimi territorial i Serbisë ndaj Kosovës, i etabluar në kushtetutën e vendit. Në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, të miratuar në vitin 2009, Serbia e konsideron “ndarjen e krahinës autonome të Kosovës dhe Metohisë) si një nga kërcënimet kryesore të sigurisë (Republika e Serbisë 2009). Këto qëndrime dhe probleme të kësaj natyre “vazhdojnë të mbesin pengesa kryesore në bashkëpunimin ndërshtetëror dhe sigurinë rajonale në Ballkanin Perëndimor” (Bugajski & Conley, 2011). Ekspertët e sigurisë në rajon vlerësojnë se përderisa ekziston një dinamikë e tillë, që nuk garanton integritetin territorial të Kosovës, ekzistenca dhe mirëqenia si shtet i pavarur vihet në pikëpyetje (Nikolla, 2012). Megjithatë, këtu ekziston edhe një paradoks në kuptim të sigurisë i cili duhet menaxhuar me kujdes, andaj sa më shumë që të përparoj dialogu për të normalizuar marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës, do të rritet rreziku i akteve të dhunës nga qarqet radikale (Clapper, 2013).

Gjatë viteve 2011-2012, kur Qeveria tentoi të vë nën kontroll dy pikë kalimet kufitare në veri të vendit, situata eskaloj dhe u karakterizua me incidente të dhunshme. Operacioni policor për marrjen e kontrollit në këto pika kufitare nxiti reagimin e dhunshëm nga ana e Serbëve të veriut të cilët refuzojnë të pranojnë autoritetin e Qeverisë dhe pengojnë çdo iniciativë për shtrirjen e këtij autoriteti në pikat kufitare (Lowen, 2011). KFOR liroi njësitë policore të Kosovës nga përgjegjësia për kontrollimin e pikave kufitare, ndërkohë që si pasojë e vendosjes dhe largimit të barrkadave që kishin për synim pengimin e Qeverisë për të shtrirë autoritetin në veri të vendit dhe në pikat kufitare me Serbinë, për më shumë se një vit pati përplasje të vazhdueshme në mes të Serbëve të Kosovës dhe njësiteve të KFOR-it (Bytyci, 2011). Eskalimi i situatës në akte të dhunshme “ka rritur shqetësimet që ndërlidhen me sigurinë, dhe ka sinjalizuar domosdoshmërinë për të zgjidhur statusin e komunave veriore të dominuara nga popullsia serbe” (Bugajski & Conley, 2011).

Edhe pse publikisht nuk janë asocuar me aktet e fundit të dhunës në veriun e Kosovës, strukturat paralele Serbe dhe veçanërisht organizatat për mbrojtje civile, paraqesin një forcë që duhet parë me shqetësim. Ekzistojnë raporte që tregojnë se agjensioni për mbrojtje civile në Mitrovicë ka rreth 400 të punësuar të cilët gjinden në listën e pagave të

Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë (Koha Ditore, 2012). Por edhe më shqetësues është fakti që duke u thirrur në Nenin 65 të Konventës së Gjenevës, kjo organizatë publikisht ka pranuar se anëtarët e saj “kanë të drejtë të mbajnë armë të lehta për të ruajtur rendin dhe për tu vetëmbrojtur” (Koha Ditore, 2012). Marrëveshja e arritur mes Republikës së Serbisë dhe Republikës së Kosovës, me ndërmjetësimin e BE, përfshinë edhe dispozita të cilat parashohin transformimin e strukturave paralele të sigurisë. Në marrëveshje theksohet se “anëtarët të strukturave të tjera të sigurisë do të kenë mundësi të angazhohen në struktura ekuivalente të shtetit të Kosovës” (Brajshori & Jovanovic, 2013). Por, elementi thelbësor në tërë këtë proces mbetet zbatimi i marrëveshjes, ndërkohë që në disa raporte theksohet se madje zbatimi i marrëveshjes duhet të filloj me tërheqjen e strukturave paralele të sigurisë nga veriu i Kosovës (Andric, 2013).

Aktualisht, prezenca e paqeruajtëseve ndërkombëtarë e zvogëlon mundësinë që ky kërcënim të rrezikoj interesat shtetërore të Kosovës. Por, duhet theksuar se vetëm KFOR-i dhe jo FSK-ja, mbetet forca e vetme me kapacitetin për mbrojtur integritetin territoriale të Kosovës.⁸ Si rezultat i eskalimit të situatës në akte të dhunshme në veri dhe kapacitetit të kufizuar të institucioneve të Kosovës përgjegjëse për sigurinë për të menaxhuar këtë kërcënim, dhe me qëllim që të mos rrezikohet situata e sigurisë, NATO ka ngadalësuar realizimin e planeve për zvogëlimin e numrit të trupave të KFOR-it (Rasmussen, 2012). Si pjesë e kësaj analize, ky element paraqet një rrezik serioz për interesin shtetëror të “pavarësisë dhe integritetit territorial”, ndërkohë që rreziku i përgjithshëm ndaj këtij interesi shtetëror vlerësohet të jetë mesatar.

Stabiliteti rajonal paraqet një kërcënim tjetër që ndërlidhet me aspektin politik. Konfliktet e pazgjidhura etnike në Ballkan dhe kriza ekonomike globale që ka përfshirë Eurozonën rrezikojnë interesat shtetërore të “sigurisë dhe stabilitetit në rajon” dhe “kushteve që mundësojnë zhvillim ekonomik. Në fillim të vitit 2012, pas disa vrasjeve me motive

⁸ Më 9 Korrik, 2013 “Këshilli i Aleancës Atlantike deklaroi se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur kapacitetet e plotë operacionale dhe është plotësisht në gjendje të kryej detyrat të cilat i janë dhënë me mandatin e saj, në përputhje me standardet e përcaktuara nga NATO. Vandiver, J. (2013, 9 Korrik). “NATO vlerëson se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur kapacitetin e plotë operacionale. Stars and Stripes. Marrë nga: <http://www.stripes.com/news/europe/kosovo-security-force-recognized-as-fully-operational-by-nato-1.229553>

etnike në rrethinën e Shkupit dhe përplasjeve që pasuan në mes të policisë dhe protestuesve, frika e një konflikti të gjerë etnik përfshiu sërish Maqedoninë (Synovitz & Blagoje Kuzmanovski, 2012). Përderisa konflikti etnik nuk u zgjerua në përmasat e atij të dhjetë viteve më parë, vendi vazhdon të sfidohet edhe nga fërkimet ndërshtetërore me Greqinë dhe Bullgarinë (Clapper, 2013). Në Bosnje, mospajtimet në mes të tri grupeve më të mëdha etnike të dala nga Marrëveshja e Dejtonit, kanë rezultuar me regres duke vënë në pikëpyetje kështu funksionalitetin e madje edhe mbijetesën e shtetit (Bugajski & Conley, 2011). Në Shqipëri, korrupsioni dhe institucionet qeveritare të dobëta si dhe tendosjet e vazhdueshme në jetën parlamentare, kanë ngadalësuar progresin drejt realizimit të reformave të nevojshme (Clapper, 2013). Në aspektin ekonomik, edhe pse pjesa dërmuese e Ballkanit vazhdon përgatitjet për anëtarësim në BE, efektet e krizës në Eurozonë kanë qenë shkatërruese dhe për pasojë është shënuar rritje mesatare e GDP për vetëm 1.9%, e parashikimet tregojnë për rënie të sërishme të kësaj përqindje (INSS, 2012). Andaj, probabiliteti për trazira sociale të nxitura nga sfidat ekonomike në tërë rajonin është duke u rritur. “Në Greqi këto trazira tashmë kanë marrë jetë njerëzish, ndërkohë që në Itali dhe Spanjë, protestuesit vazhdojnë të jenë paqësor” (Heinze, 2013).

Sfidat jo tradicionale ndaj sektorit të sigurisë e bëjnë edhe më komplekse sfidën e mbrojtjes së interesave shtetërore të Kosovës. Krimi i organizuar ndërkombëtar, ekstremizmi i dhunshëm dhe kërcënimet mjedisore mund të kenë pasoja të konsiderueshme për interesat shtetërore të Kosovës. Këtu burime jo ushtarake të konfliktit vënë në rrezik të ndryshme interesat shtetërore të “konsolidimit të shtetit demokratik”, sigurisë dhe stabilitetit në rajon” dhe “kushteve që mundësojnë stabilitet ekonomik”.

Vendet me zhvillim të ulët ekonomik, institucionet qeveritare joefikase dhe sfidat në sundimin e ligjit krijojnë një mjedis të favorshëm për lulëzimin e krijimit të organizuar ndërkombëtar. “Krimi i organizuar ndërkombëtar (KON), paraqet një kërcënim serioz dhe në rritje për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, që ndikon drejtpërdrejt në sigurinë publike, shëndetin publik, institucionet demokratike dhe stabilitetin ekonomik përgjatë globit” (Shtëpia e Bardhë, 2011). Krimi i organizuar ndërkombëtar që mbizotëron në Ballkan vë në rrezik interesat kombëtare të “sigurisë dhe stabilitetit rajonal” dhe

“konsolidimit të shtetit demokratik”. Ky rajon mbetet vrimë e zezë ku përmes krimit të organizuar ndërkombëtar, për në Evropën Perëndimore trafikohet drogë, qenie njerëzore dhe armë. Edhe pse nuk është vend ku substancat narkotike prodhohen në masë të gjerë, Kosova vazhdon të konsiderohet si vendi kryesor transit për drogën e dedikuar për tregjet Evropiane (U.S. DSh, 2012). Gjatë vitit 2011, Policia e Kosovës ka konfiskuar 96.8 kg marihuanë, 33.1 kg heroinë dhe 2.6 kg kokainë. (U.S. DSh, 2012). Gjithashtu, Kosova konsiderohet si “burim, vend transit dhe destinacion për gra dhe fëmijë të cilët janë subjekt i trafikimit me qenie njerëzore, sidomos në prostitucion të detyruar për gratë, dhe kërkim lëmshës për fëmijët (U.S. DSh, 2010). Në sferën e armëve, tërë rajoni karakterizohet me prezencën e një sasive të madhe të armatimit të mbetur pas shkatërrimit të Jugosllavisë, ndërkohë që Ballkani përveç se është treg i armëve, konsiderohet jo vetëm si akter i rëndësishëm në tregtinë e tyre (Grillot, 2010). Disa analistë vlerësojnë se rreth 1/3 e të gjitha armëve ilegale që hyjnë në Bashkimin Evropian vijnë nga vendet e ish Jugosllavisë (Palic, 2013). Një hulumtim mbi posedimin e armëve të vogla i kryer në Zvicërr, thekson se numri i tyre për kokë banori në vendet e ish Jugosllavisë është si vijon “Serbia 38 armë në 100 banorë (në vendin e 5-të në botë), Maqedonia 24/100, Mali i Zi 23/100, Kroacia 22/100, Kosova 19.5/100, Bosnja dhe Hercegovina 17/100 dhe Sllovenia 13/100 (Hulumtim mbi Armët e Vogla 2012). Hulumtimi ka shpalosur që Kroacia dhe Bosnja kanë probleme serioze me fushat e minuara (rreth 90,000, respektivisht 120,000) (Hulumtim mbi Armët e Vogla, 2012). Forumi për Siguri ka bërë të ditur që nga viti 2000 deri në vitin 2011 në Kosovë janë konfiskuar 17,142 armë (Hulumtim mbi Armët e Vogla 2012). Një shqetësim tjetër është ndërlydhja në mes të krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit. Në këtë simbioze krim-terror, terroristët drejtohen tek krimi i organizuar ndërkombëtar për të kërkuar fonde dhe mbështetje logjistike për veprimet e tyre. Krimi i organizuar ndërkombëtar paraqet një sfidë domethënëse për rajonin dhe Kosovën në mbrojtjen e interesave shtetërore të “sigurisë dhe stabilitetit në rajon” dhe “konsolidimit të shtetit demokratik”, ndërkohë që rreziku i përgjithshëm nga ky element vlerësohet të jetë mesatar.

Një kërcënim tjetër që sfidon vendet me zhvillim të ulët ekonomik dhe institucione qeveritare joefikase janë ekstremistët të cilët kërcënojnë dhe përdorin aktet e dhunshme për të shtyrë përpara agjendat e tyre. Me qëllim që të ndjellin frikë, këta ekstremistë të dhunshëm drejtojnë sulmet e tyre ndaj individëve, grupeve të caktuara, objekteve me karakter etnik,

apo grupeve të caktuara varësisht nga preferencat politike, religjioze apo seksuale. (Bieber, 2003). Në kontekstin rajonal, Ballkani ka qenë cak i sulmeve terroriste siç ishte sulmi ndaj Ambasadës së SHBA-ve në Sarajevë, Bosnje (Tetor 2002) dhe autobusit me turistë në Burgas, Bullgari (Korrik 2012) (Bardos, 2012). Gjatë vitit 2012, edhe Serbia ka kryer disa operacione anti terroriste të drejtuara kundër terroristëve të cilët planifikonin sulme ndaj ambasadave në Beograd (Bardos, 2012). Derisa probabiliteti dhe pasojat nga kërcënimet e organizatave ekstremiste në rajon dallojnë, analistët pajtohen që mungesa e sundimit të ligjit, institucionet qeveritare joefikase dhe korrupsioni kanë ndihmuar në rritjen dhe rishfaqjen e organizatave ekstremiste politike dhe religjioze (Karadaku, 2013).

Ekspertët pohojnë se përderisa shumica e komuniteteve islamike në Ballkan “janë hequr nga agjendat që ndërlihen me terrorizmin”, terroristët islamistë kanë gjetur mundësi të reja në Ballkan përmes organizatave islamike me karakter humanitar dhe promovuesve të sektit Wahhabi (Tziampiris, 2009). Në rastin e Kosovës vlerësohet se vetëm një fraksion i vogël lokal që ka lidhje me fundamentalistët në nivel global “mund të tërhiqet në ekstremizmin islamik dhe aktivitet që ndërlihen me të” (Deliso, 2007). Në fushën e ekstremizmit politik, sulmet me granata në veriun e Kosovës (mbi 20 sulme brenda dy muajve të fundit), konsiderohen si taktika dhe akte terroriste të drejtuara nga individët, familjet, forcat e sigurisë apo objektet kulturore (AP, 2013).⁹ Synimi i këtyre sulmeve mendohet të jetë provokimi dhe nxitja e dhunës në shkallë të gjerë, apo thjeshtë reagime sporadike kundër prezencës së policisë apo paqeruajtësve ndërkombëtar. Edhe pse trendet e terrorizmit në rajon dhe brenda Kosovës karakterizohen me metoda të sulmeve me pasoja të vogla në krahasim me përmasat katastrofike të sulmeve terroriste në nivel global, ato shpesh kanë arritur efektin e dëshiruar politik. Fatkeqësisht, shumica e këtyre sulmeve ende janë nën hetime dhe kryesit e këtyre veprave ende nuk janë sjellë para drejtësisë. Meqenëse sulmet terroriste në rajon dhe në Kosovë konsiderohen të kenë pasoja të vogla, në përgjithësi paraqesin rrezik të ulët për interesat shtetërore të “sigurisë dhe stabilitetit në rajon” dhe “konsolidimit të shtetit demokratik.”

⁹ Shumë nga sulmet me granata kanë pasur si cak objektet e ndryshme, dhe vetëm disa prej tyre kanë pasur cak qytetarët.

Kërcënime mjedisore paraqiten kryesisht në formë të katastrofave natyrore të cilat mund të kenë pasoja të konsiderueshme për sigurinë e individëve dhe komuniteteve. Këto ngjarje katastrofike jo vetëm që rrezikojnë jetët e njerëzve por kanë efekte shkatërruese në ekonomi, veçanërisht në vendet në zhvillim. (UNU, 2011). Sa i përket Kosovës, gjatë viteve të fundit Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është dislokuar dy herë për të ndihmuar në menaxhimin e krizës së përmbajtjeve në Shqipëri dhe për kryerjen e operacioneve të shpëtimit gjatë të reshurave të mëdha të borës në Kosovë. Sidoqoftë, vlerësohet se në përgjithësi kërcënimet e natyrës mjedisore paraqesin rrezik të ulët për interesat shtetërore të “sigurisë dhe stabilitetit në rajon” dhe “krijimit të kushteve për stabilitet ekonomik.”

9. Alternativat Strategjike

Vendimet rreth arkitekturës së sektorit të sigurisë së Kosovës duhet të bazohen në kritere të qarta që pasqyrojnë interesat shtetërore dhe jo kompromiset në mes të institucioneve të ndryshme të sektorit të sigurisë (të brendshme apo të jashtme). Vendimet kryesore duhet të merren duke zgjedhur në mesin e alternativave të qarta, të balancuara dhe të mundshme. Kjo analizë paraqet një nga ato alternativa.

Esenca e çdo strategjie është përcaktimi i prioriteteve për mënyrat dhe mjetet e nevojshme për të arritur qëllimin e caktuar. Prandaj edhe rekomandime që ofrohen në fund të kësaj analize ndjekin logjikën e njëjtë. Pasi të jetë bërë vlerësimi i kushteve të mjedisit strategjik, interesave shtetërore, kërcënimeve dhe mundësive, krijohen mundësitë që të rishikohet tërë arkitektura e sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë në Kosovë. Këto mundësi vijnë në formë të rekomandimeve për rishikimin e rolit dhe misionit, strukturës së sektorit të sigurisë dhe reformave në fushën e mbrojtjes. Në këtë drejtim mund të punohet edhe në promovimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, me qëllim që të mbrohen interesat shtetërore.

Rolet dhe misioni: në kontekst të kësaj analize me nocionin “rolet” nënkuptohen qëllimet e përgjithshme për të cilat forcat e armatosura krijohen me ligj, ndërsa me nocionin “misionet” nënkuptohen aktivitetet e gjera të cilat kërkohen për të mbrojtur interesat shtetërore, e që janë karakteristikë e forcave të armatosura. Kërcënimet e vazhdueshme ndaj interesave shtetërore si “pavarësia dhe integriteti territorial” dhe “krijimi i kushteve për stabilitet ekonomik, janë treguesi më i mirë i domosdoshmërisë së konsolidimit të rolit dhe misionit të forcave të armatosura. Për çdo qeveri nuk ka asnjë gjë më prioritare se mbrojtja e sovranitetit të shtetit, qytetarëve dhe interesave shtetërore të sigurisë. Në këtë drejtim, asnjë institucion nuk është më i rëndësishëm për mbijetesën e shtetit se forcat e armatosura (Barany, 2012). **Andaj, roli kryesor i forcave të armatosura është të ruaj pavarësinë dhe integritetin territorial të shtetit, përmes zbulimit, zbrapsjes, parandalimit, dhe nëse është e nevojshme luftimit të kërcënimeve dhe agresionit ndaj shtetit.** Ky rol është në funksion të ushtrimit të së drejtës themelore të

shteteve për t'u vetëmbrojtur në rastet kur ndeshen me sulme të armatosura (Kombet e Bashkuara, 1945).

Në aspektin afatshkurtër kushtet në mjedisin strategjik mund të mos jenë të favorshme që Kosova të ndërtoj një forcë ushtarake të gatshme për të kryer funksione dhe operacione, në nivelin e njejtë me ushtritë e shteteve të perëndimit. Kjo nuk nënkupton që forcat e armatosura të dizajnuara për të ruajtur pavarësinë dhe integritetin territorial nuk kanë kapacitet për të kryer misione të cilat mbrojnë interesat tjera shtetërore (p.sh menaxhimi i katastrofave, në mbështetje të sigurisë dhe stabilitetit rajonal). Megjithatë, nuk është në interesin më të mirë që të sakrifikohen asetet shtetërore për të ndërtuar dhe mbajtur forca të armatosura që nuk janë në gjendje ti kryejnë rolet dhe misionet elementare. **Andaj, forcat e armatosura duhet të jenë në gjendje të kryejnë me sukses funksionet në vijim: misionet luftarake, ruajtjen e sigurisë dhe mbështetjen e autoriteteve civile.**

Misionet luftarake përqendrohen në zbrapsjen e armiqve të armatosur përmes aplikimit të organizuar të forcës vdekjeprurëse, shkatërrimit apo kapjes së tyre me të gjitha mjetet që janë në dispozicion (Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-ve - 2010).¹⁰ Misionet e sigurisë përqendrohen në mbrojtjen e qytetarëve, territorit dhe resurseve, nga kërcënimet dhe sulmet e jashtme (Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-ve - 2010). Ndërsa, mbështetja për autoritetet civile, nënkupton angazhimin e forcave të armatosura për të ndihmuar në menaxhimin e pasojave të katastrofave natyrore apo atyre të shkaktuara nga njeriu. Këto rekomandime nuk do të kërkonin ndryshime thelbësore në misionin aktual të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK): “të kryej operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë vendit, operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës, si dhe t'i ndihmoj autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera (Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, 2008). Megjithatë, tranzicioni nga “reagim ndaj krizave” në “operacione luftarake” mund të presupozohet si transferim i detyrave dhe kapaciteteve dytësore tek ministritë dhe institucionet tjera.

¹⁰ Hulumtuesi kryesor në këtë studim ka qenë Departamenti i Shtetit (SHBA) dhe Ushtria, me qëllim që të avancohet në zhvillimin e këtyre koncepteve.

Në kuadër të roleve dhe misionëve të shtjelluara më lartë, operacione tipike të forcave të armatosura do të mund të përfshinin: mbrojtjen territoriale, mbështetjen civile, ndihmën humanitare, operacionet e sigurisë dhe operacionet paqësore. Operacionet për mbrojtje territoriale kërkojnë kapacitete për të mbrojtur sovranitetin, territorin, qytetarët dhe infrastrukturën me rëndësi kritike ndaj kërcënimeve dhe sulmeve nga jashtë. Mbështetja civile dhe operacionet humanitare kanë për synim mbështetjen e ministrive dhe institucioneve të tjera (vendore dhe ndërkombëtare) që të lehtësojnë apo zvogëlojnë vuajtjet e qytetarëve në rastet e katastrofave natyrore apo atyre të shkaktuara nga njeriu. Bashkëpunimi në këto aktivitete përfshin edhe ndërveprimin me ministrinë e mbrojtjes dhe ushtritë e vendeve të tjera në mënyrë që të ndërtohet partneritetet dhe kapacitete për operacione të përbashkëta ushtarake, gjë që të do promovonte interesat shtetërore të Kosovës (Publikim i Përbashkët i Aleancës 01(D), 2010).¹¹

Operacionet e paqes mund të përfshijnë aktivitetet e kryera jashtë vendit, në kuadër të kornizave të organizatave rajonale apo ndërkombëtare, me qëllim të vendosjes e ruajtjes së paqes në vendet e përfshira në konflikt, për të mbajtur rendin dhe sigurinë.

Ne nuk synojmë të krahasohemi me asnjë vend tjetër, por thjesht vetëm të plotësojmë nevojat tona të sigurisë për aq sa është e përballueshme me buxhetin tonë, dhe në asnjë mënyrë të paraqesim kërcënim për dikë tjetër.– Agim Çeku, Ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Struktura e forcave të armatosura: Kosova ka arritur një pikë kthese në zhvillimin dhe shfrytëzimin e forcave të armatosura. Në mënyrë që forcat e armatosura të jenë në gjendje të përballojnë sfidat e lartpërmendura, Qeveria duhet të reflektoj mbi rreziqet dhe mundësitë në aspektin afatshkurtër dhe afatgjatë, në mënyrë që të krijoj alternativa për strukturën e forcave të armatosura, si në kuptim të numrit (kapaciteteve) ashtu edhe të aftësive të veprimit. Këtë e përcaktojnë gjithmonë rolet dhe misionet e shtjelluara më lartë.

¹¹ Publikim i Përbashkët i Aleancës NATO 01(D) "Doktrina e Përbashkët e Aleancës", thekson që me kapacitetet për operacione të përbashkëta nënkuptohet aftësia për të vepruar së bashku në mënyrë koherente, efektive dhe efikase. Edhe pse kjo nuk përfshin ndërtimin e sistemit të armëve kompatibil me vendet tjera, nënkupton harmonizimin e doktrinës dhe terminologjisë mbi bazën e së cilës do të ndërtohej një kornizë e përbashkët operacionale.

Nëse një shtet dëshiron të jetë në gjendje të përballoj luftën, atëherë duhet të demonstroj aftësi kredibile për të luftuar dhe për të fituar luftën. Mënyra më e mirë për të demonstruar këtë aftësi është krijimi i njësisve të fuqishme ushtarake të këmbësisë, që janë në gjendje të zbrapsin forcat tokësore armike, të kontrollojnë territore ku është vendosur infrastruktura me rëndësi kritike apo grupe të caktuara të qytetarëve (Mearsheimer, 2001). Forcat e këmbësisë mund të kryejnë edhe misione të tjera që forcojnë forcën zbrapëse, ndërhyjnë në rastet e emergjencave brenda vendit, mbështesin nevojat humanitare dhe sigurojnë mbështetje për aleatët.

Megjithatë, ky rishikim strategjik i mbrojtjes është i realizueshëm vetëm për ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësive të FSK-së në aspektin afatshkurtër dhe afatmesëm, në mënyrë që të jetë e gatshme për të përballuar vetëm sulmet e armatosura nga jashtë. Kufizimet në resurse do ta vështirësojnë shumë modernizimin dhe transformimin e FSK-së në ushtrinë e ardhshme të Kosovës. Gjithashtu, shpenzimet e mëdha në sektorin e sigurisë do të absorbonin një përqindje të konsiderueshme të buxhetit të shtetit, që do të mund të shfrytëzohej për sektorët tjerë. Andaj, nëse Kosova kërcënohet nga ndonjë fuqi ushtarake me kapacitete dhe aftësi të papërballueshme për FSK-në, atëherë duhet të gjejë mbështetje tek partnerët rajonal dhe Euro-Atlantik. Megjithatë, për aq sa është e mundur, Kosova duhet të punojë në ndërtimin e kapaciteteve për t'u vetëmbrojtur. Me gjithë kërcënimet ndaj interesit kombëtar të pavarësisë dhe integritetit territorial, prezenca e KFOR-it dhe deri diku e EULEX-it, ndihmon në menaxhimin e rrezikut në këtë periudhë kur Kosova po ndërton institucione e saja të sigurisë. KFOR-i dhe EULEX-i vazhdojnë të ofrojnë shumë mundësi për Kosovën. Para së gjithash, në përputhje me mandatin e dhënë, KFOR-i garanton një mjedis të sigurt për ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve të shtetit të Kosovës. Strukturimi dhe reduktimi i vazhdueshëm i trupave të KFOR-it, ndërlidhet drejtpërdrejt me përmirësimin e situatës së sigurisë, e që njëkohësisht është tregues pozitiv për interesat shtetërore të Kosovës. Sidoqoftë, sa herë që tensionet janë ngritur NATO ka ngadalësuar zbatimin e strategjisë së reduktimit dhe ristrukturimit të trupave, ndërkohë që ka pasur raste kur edhe ka dislokuar forca shtesë rezervë. Ekziston gjithmonë rreziku që si rezultat i vendimeve të natyrës politike dhe ekonomike, të ketë zhvendosje dhe dislokim të trupave të KFOR-it nga shtetet kontribuuese për në vendet tjera, gjë që do të krijonte zbrazëtira në sektorin e sigurisë që do të duhet të mbusheshin nga forcat

e armatosura të Kosovës brenda një periudhe të shkurtër, me gjithë faktin që mund të jenë të papërgatitura si duhet për ato përgjegjësi.

Mandati i EULEX në fushën e sundimit të ligjit ndihmon interesin shtetëror të konsolidimit të shtetit demokratik. EULEX paraqet një mundësi të mirë për ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve përgjegjëse në fushën e sundimit të ligjit, strategjive për ballafaqim me krimin e organizuar ndërkombëtar, terrorizmin dhe ekstremistët e dhunshëm.

Një mundësi të dytë që ofron KFOR-i janë aktivitetet me karakter këshillues, trajnues dhe mentorues, të cilat kanë efekt pozitiv në konsolidimin e FSK-së dhe përgatitjen e saj për tu transferuar në ushtrinë e ardhshme të Kosovës. Për shembull, në kuadër të procesit të RSSS-së të udhëhequr nga Qeveria, një ekip këshillues i NATO-s këshillon Ministrinë e FSK-së në rishikimin strategjik të forcës së sigurisë (Beardsley, 2012). Gjithashtu, ekipet trajnuese të NATO-s kanë ndihmuar në trajnimin e FSK-së në ndërtimin e kapaciteteve themelore ushtarake të dizajnuara për rritur kapacitetin e brendshëm operacional.

Transformimi i FSK-së në ushtri tradicionale kërkon rebalancimin e forcës ekzistuese të sigurisë dhe kapaciteteve operacionale. Tabela numër 2 "Transformimi i FSK-së" që paraqet një analizë krahasuese për kapacitetin aktual të FSK-së, FSK-së dhe KFOR-it, dhe tabela numër 1 që paraqet "Balancin Ushtarak të Shteteve të Ballkanit Perëndimor", synojnë të ofrojnë një pasqyrë të gjendjes reale në terren dhe të justifikojnë propozimin për strukturimin e forcave të armatosura të Kosovës në të ardhmen. Duke marrë parasysh që Kosova është një shtet i formuar rishtazi, çfarëdo analize që bëhet do të konstatoj që kapacitetet dhe aftësitë operacionale të FSK-së janë dukshëm më të vogla se ato të ushtrive të rajonit. Duke vlerësuar kërcënimet kryesore ndaj interesave shtetërore dhe duke bërë krahasime me forcat e armatosurat të shteteve të rajonit, kjo analizë rekomandon rritjen e forcave të armatosura si për nga kapaciteti ashtu edhe për aftësia operacionale në mënyrë që të mund të përmbushin mandatin e dhënë me Kushtetutë. Duke marrë parasysh strukturën aktuale të FSK-së dhe prezencën e KFOR-it, propozohet që ngritja e kapaciteteve të FSK-së dhe plani për transformimin në ushtri të zhvillohet në disa faza.

Tabela 2: Transformimi i FSK-së				
	Forcat tokësore	Forcat rezervë	Njësitë kryesore të këmbësores	Njësitë kryesore të aviacionit
Forca e Sigurisë së Kosovës (aktualisht dhe pa KFOR-in)	2,500	800	1 x Brigadë të këmbësores	Asnjë
Forcat e Sigurisë së Kosovës (me KFOR-in) ^{1,2}	7,365 (2,500 FSK + 4,865 KFOR)	1,500 (800 FSK + 700 NATO FRO*)	1 x Brigadë të këmbësores + 2 x Grupe Luftarake	
Forca tokësore krahasuar me rajonin ³	7,500	1,500	1 x Brigadë të këmbësores 1 x Batalion i Forcave Speciale 1 x Batalion i zbulimit	1 x Skuadrile e Helikopterëve SQN
Propozimi për Forcat e Sigurisë së Kosovës	5,000	1,500	1 x Brigadë të këmbësores 1 x Batalion i Forcave Speciale 1 x Batalion i Zbulimit 2 x Batalion i Këmbësores (Rezervë)	1 x Skuadrile e Helikopterëve
<p>*FRO: Forcat Operacionale Rezervë</p> <p>Referencat:</p> <p>1. NATO Misioni në Kosovo (n.d.). KFOR: <i>Fakte dhe Statistika</i>. Marrë nga: http://www.aco.nato.int/kfor/library/facts-figures.aspx</p> <p>2. NATO Misioni në Kosovo (n.d.). KFOR: <i>Fakte dhe statistika</i>. Marrë nga: http://www.aco.nato.int/resources/site7423/General/Documents/kfor_placemat.pdf</p> <p>3. Referenca: Instituti Ndërkombëtar për Studime Strategjike (2013). Balanci Ushtarak. Londër, Mbretëria e Bashkuar 113:1, 543-556</p>				

Sa i përket qasjes për rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të forcave të armatosura, në përgjithësi kjo do të mund të bëhet në tri faza:

1. Konsolidimi dhe riorganizimi;
2. Sigurimi i armëve dhe mjeteve mbështetëse luftarake
3. Zgjerimi i forcës rezervë

Elementi kyç në procesin e transformimit është transferimi i roleve dhe misionëve përkatëse tek ministritë dhe institucionet tjera, si dhe shfrytëzimi më efikas i forcave rezervë. Fillimisht, përgjegjësitë për reagim ndaj situatave emergjente, për të cilat FSK duhet të ndërtoj kapacitete të brendshme, duhet të transferohen tek ministritë apo institucionet tjera (si p.sh Ministria e Punëve të Brendshme apo Agjensioni për Menaxhimin e Emergjencave). Kjo do të mundësonte që resurset edhe ashtu të kufizuara të forcave të armatosura të përqendrohen në transformimin dhe modernizimin e nevojshëm për të kryer misionë luftarake, operacione të sigurisë dhe operacione në mbështetje të autoriteteve civile. Gjithashtu, forcat rezervë mund të bëhen pjesë integrale e forcave të armatosura të Kosovës, duke ndikuar kështu në rritjen e kapaciteteve dhe aftësive operacionale. Forcat rezervë zakonisht janë më të kufizuara për nga kapacitetet dhe aftësitë, por një pjesë e tyre posedojnë shkathtësi të caktuara të natyrës civile. Një model i forcave rezervë i cili përfiton nga organizimi në njësi më të vogla mundëson zgjerimin e kapaciteteve, në një periudhë kur tërë forca e sigurisë po kalon në një fazë evoluimi.

Propozimi për strukturën e forcës së sigurisë është ilustruar në figurën 1.¹²




Figura 1: Propozimi për strukturën e Forcave të Armatosura

Faza e parë e këtij transformimi respektivisht “**Konsolidimi dhe Riorganizimi**” parashih që rolet dhe misionet për reagim ndaj emergjencave në nivel të vendit të transferohen tek ministrinë apo institucionet tjera përkatëse. Në këtë drejtim, operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, trajtimi i materialeve të rrezikshme, shuarja e zjarreve dhe kapacitetet tjera të dizajnuara për ndihmë humanitare të transferohen ose tek Ministria e Punëve të Brendshme ose tek Agjencioni për Menaxhimin e Emergjencave. Natyrisht, kjo do të ndikonte në paraqitjen e nevojës për zgjerimin e kapaciteteve të këtyre institucioneve. Në anën tjetër, procesi i riorganizimit të Brigadës për Operacionet Mbështetëse do të përfshinte ndërtimin dhe konsolidimin e kapaciteteve të nevojshme për kryerjen e operacioneve luftarake dhe atyre të sigurisë - respektivisht

¹² INF BDE – Brigada e Këmbësisë
 RECCE BN – Batalion i Zbulimit
 SOF BN – Batalion i Forcave Special të Armatosura
 HELO SQN – Skuadrile e Helikopterëve
 SPT BN – Batalion Mbështetës
 TRADOC – Komanda e Trajnimit dhe Komandës
 RESERVE INF BN – Brigada e Këmbësisë Rezervë

këmbësorinë, operacionet speciale dhe njësitë e zbulimit. Njësitë e mbetura të shërbimit dhe mbështetjes, në kuadër të Brigadës për Operacionet Mbështetëse do të mund të organizoheshin në nivel të batalionit. Paralelisht, kapaciteti aktual i forcave rezervë do të rikonfigurohej në grupe të vogla dhe pastaj do të trajnohen dhe pajisen në mënyrë adekuate për të qenë në gjendje të mobilizohen. Këto njësi rezervë mund të mobilizohen për shërbim aktiv në kohë lufte apo emergjence në nivel vendi dhe të plotësojnë nevojat e forcave të armatosura të rregullta.

Gjithashtu, për këtë fazë të transformimit rekomandohet që forcat e armatosura të vazhdojnë avancimin e bashkëpunimit ushtarak brenda kornizës së NATO-s, në mënyrë që të trajnohen që të marrin pjesë në mënyrë efikase në operacionet e përbashkëta me partnerët e rajonit dhe të NATO-s. Kapacitetet e përbashkëta operacionale arrihen përmes standardizimit të doktrinave dhe procedurave për arritjen dhe ruajtjen e nivelit të domosdoshëm të harmonizimit, shkëmbimit dhe përafrimit në fushën operacionale, teknike dhe administrative. Ky rekomandim ndërlihet drejtpërdrejt me synimin për integrim në institucionet e sigurisë të nivelit Trans-Atlantik.

Faza e dytë e procesit të transformimit, respektivisht **“Sigurimi i armëve dhe mjeteve mbështetëse luftarake”** parasheh krijimin dhe avancimin e kapaciteteve dhe aftësive operacionale të forcave të armatosura. Sipas mandatit aktual FSK është e armatosur me armë të lehta, dhe vetëm rishtazi është pajisur me mjete të blinduara falë ndihmës së Turqisë (Koci, 2013). Në këtë gjendje, forcat e armatosura me armë të lehta dhe pamundësia për të lëvizur në terren paraqet një sfidë të madhe në zbrapsjen e sulmeve të jashtme ndaj territorit të vendit. Përderisa është e qartë që ndërtimi i një ushtrie të pajisur me tanke luftarake, mjete motorike të këmbësorisë, artileri dhe helikopterë sulmues nuk është i mundshëm, pajisja e këmbësorisë me armë të kalibrit të mesëm dhe të rëndë dhe granata të kalibrit të lehtë dhe të mesëm, si dhe mbështetja me forca të operacioneve speciale për zbulim dhe misione tjera specifike, është një opsion strategjik i mundshëm dhe i realizueshëm. Një zbrazëti tjetër në këtë drejtim është edhe kapaciteti i kufizuar për të ruajtur interesat shtetërore.

Kjo analizë rekomandon që forcat e armatosura të ristrukturohen në atë mënyrë që të përfshijnë edhe njësi me kapacitet për të kryer luftime në distancë të afërt në të gjitha situatat e mundshme përgjatë konfliktit. Brigada aktuale e FSK-së për Reagim të Shpejtë, që njëherit konsiderohet si njësi bazë e FSK për dislokim në betejë, duhet të transformohet në mënyrë që t'i kundërpërgjigjet armikut me forcën e armëve të zjarrit, dhe sulmeve taktike që kanë për synim shkatërrimin ose kapjen e forcave armike. Në të ardhmen, brigadat duhet të organizohen në batalione të këmbësorisë, si njësitë primare për manovrim që mbështeten përbrenda nga njësitë e zbulimit, njësitë e snajperëve dhe njësitë me armë të rënda. Në mbështetje të kësaj brigade, kjo analizë rekomandon themelimin e njësive të specializuara për zbulim, njësive për operacione speciale dhe njësive të aviacionit. Njësitë e zbulimit kryejnë operacione të vëzhgimit dhe zbulimit, në mënyrë që t'i ofrojnë informacione dhe mbështetje komandantit të zonës për të kuptuar më mirë situatën dhe për vendosur për operacionet ushtarake. Njësitë e zbulimit mund të përdoren edhe në operacionet e sigurisë për të mbrojtur dhe mbuluar njësitë lokale dhe rajonale të sigurisë. Njësitë për operacione speciale përfshijnë forcat e trajnuara dhe pajisura me mjetet adekuate për të kryer një sërë operacionesh dhe aktivitësh që mund të përfshijnë luftën jo konvencionale, aksionet e drejtpërdrejta, operacionet speciale të zbulimit dhe operacionet anti terroriste. Dhe në fund, njësitë e helikopterëve përbëjnë një pjesë esenciale të operacioneve luftarake, sigurisë dhe mbështetjes për autoriteteve civile. Helikopterët ndihmojnë si mjete luftarake sulmuese, por edhe për kryerjen e zbulimit dhe misioneve të sigurisë. Aktualisht FSK është duke avancuar në kodifikimin e aftësive për të ndihmuar partnerët ushtarak të rajonit (Koci, 2012).

Faza e tretë e këtij transformimi, respektivisht **“Zgjerimi i Forcës Rezervë”** është i përqendruar në trajnimin, pajisjen dhe menaxhimin e një force rezervë të aftë për dislokim në çdo zonë të Kosovës për të mbështetur autoritetet civile, dhe nëse është e nevojshme të zgjerohet dhe të mbështesë njësitë e rregullta ushtarake në misionet luftarake dhe të sigurisë. Krijimi i forcave rezervë është politikë tradicionale e mbrojtjes dhe ruajtjes së forcës efektive ushtarake pa e rritur numrin e ushtarëve aktiv. Në përgjithësi forcat rezervë kushtojnë më pak në krahasim me ushtarët e rregullt. Si opsione strategjike për strukturimin e forcës rezervë janë krijimi i një force plotësuese ose force shtesë, apo një kombinim i tyre. Njësitë rezervë me karakteristika plotësuese janë më të kufizuara për nga kapaciteti, por përdoren për të zëvendësuar ushtarët e

rregullt në pozicionet që kanë më pak karakter operacional, në mënyrë që ata të përfshihen në aktivitete ku kërkohet përgatitje më e madhe.

Njësitë rezervë me karakter të forcës shtesë ndihmojnë njësitë e rregullta ushtarake por kërkojnë kohë më të gjatë për mobilizim. Për të mbështetur funksionimin e këtyre njësive, kërkohet një kuadër aktiv me orar të plotë i cili do të merren me drejtimin, organizimin, administrimin dhe trajnimin e forcave rezervë.

Themelet kryesore mbi të cilat qëndron fuqia e të gjitha qeverive janë ligjet e mira dhe ushtritë e forta -Machiavelli

Reforma e Mbrojtjes: në mbështetje të interesave shtetërore, gjatë Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes është analizuar edhe zhvillimi i vazhdueshëm i marrëdhënieve demokratike civilo-ushtarake. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe konsolidimi i shtetit, dhe në këtë drejtim Kosova duhet të vazhdoj trajektoren drejt përmirësimit të funksionimit të institucioneve, forcave të armatosura, duke u bazuar gjithnjë në parimet demokratike (Barany, 2012). Kjo analizë rekomandon që në kuadër të reformës së mbrojtjes duhet dhënë prioritet: kontrollit demokratik të forcave të armatosura, pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe edukimin.

Kontrolli demokratik i forcave të armatosura paraqet një nga sferat ku duhet bërë përmirësime. Edhe pse dispozitat e Kushtetutës së Kosovës vendosin themele të forta për kontrollin demokratik të forcave të armatosura, institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e tyre kanë mungesë të kapaciteteve profesionale për t'u përfshirë aktivisht në çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen (Përteshi, 2011). Megjithatë, mungesa e plotë e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e institucioneve lokale, si pasojë e faktit që kompetencat në fushën e sigurisë deri vonë janë ushtruar nga administratorët ndërkombëtarë, ka vështirësuar ndërtimin e praktikave të menaxhimit dhe mbikëqyrjes civile të institucioneve të sigurisë në Kosovë (Marmullakaj&Peci, 2008). Për të siguruar avancimin e kontrollit demokratik dhe civil të forcave të armatosura kjo analizë rekomandon: ndërtimin e mëtutjeshëm të sistemit të mbikëqyrjes parlamentare dhe gjyqësore, përfshirjen aktive të komisioneve parlamentare përgjegjëse për çështjet e sigurisë, përfshirjen

e komisionit parlamentar në çështjet që ndërlidhen me aspektet financiare në fushën e mbrojtjes si dhe mbikëqyrjen e kompensimit dhe ekzekutimit të buxhetit për mbrojtje (Barany, 2012). Për të arritur këto objektiva të rishikimit strategjik të mbrojtjes, rekomandohet hartimi dhe implementimi i një programi special të edukimit në sferën e kontrollit demokratik të forcave të armatosura për përfaqësuesit e institucioneve ligjvënëse dhe gjyqësore, si dhe stafit civil të këtyre dy institucioneve.

Një sferë tjetër në rishikimin strategjik të mbrojtjes që kjo analizë rekomandon është promovimi i përfshirjes së shoqërisë civile në çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen. Synimi i këtij procesi të rishikimit mbështet rekomandimin që përfshirja e ekspertëve të pavarur civil të mbrojtjes, organizatave joqeveritare, gazetarëve, zyrtarëve të zgjedhur dhe shërbyesve civil në çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen ndikon në rritjen të transparencës dhe besimit në institucionet e shtetit, dhe veçanërisht forcat e armatosura (Barany, 2012). Përfshirja e shoqërisë civile në çështjet mbrojtjes dhe sigurisë ndihmon fuqishëm në llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë përmes fuqizimit të grupeve të marginalizuara, dialogut, debatit dhe monitorimit (UNDP, 2008). Fushat specifike në të cilat përfshirja e shoqërisë civile do t'i sillte dobi Kosovës janë: edukimi i publikut mbi çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, lehtësimi i dialogut me shoqërinë civile për çështjet e politikave, promovimin e hulumtimeve në sferën e politikave të sigurisë, promovimin e transparencës dhe llogaridhënien e institucioneve të sigurisë, monitorimin e zbatimit të reformave dhe krijimin e politikave të qëndrueshme të mbikëqyrjes si dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor që gëzon njohuri të avancuara dhe ekspertizë në sferën e mbrojtjes dhe çështjet e sigurisë (UNDP, 2008). Tutje, si pjesë e këtij rishikimi të pavarur strategjik të mbrojtjes, përfshirja e shoqërisë civile do të promovonte kushtet për inkurajimin e analizave dhe burimeve alternative të pavarura të informacionit që avancojnë demokracinë në rishikimin strategjik të mbrojtjes.

Fusha e tretë në rishikimin strategjik të mbrojtjes që promovon konsolidimin e shtetit është avancimi i mundësive për përfshirjen e zyrtarëve të forcës së sigurisë, zyrtarëve publik dhe të shoqërisë civile në programet e edukimit në fushën e studimeve strategjike të mbrojtjes. Mungesa e një universiteti ushtarak të nivelit të lartë dhe mungesa e programeve universitare në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kufizon numrin e kandidatëve të kualifikuar për të kryer mbikëqyrje parlamentare, pjesëmarrje të shoqërisë civile apo avancim të karrierës së

oficerëve ushtarak (Përteshi, 2011). Gjithashtu, ministritë duhet të kërkojnë partneritet me universitetet lokale për të: zgjeruar qasjen e zyrtarëve të lartë në programet universitare dhe avancimin e njohurive

në fushën ushtarake, zhvillimin e hulumtimeve të përbashkëta, krijimin e programeve të lidershit që inkurajojnë krijimin e liderëve të rinj ushtarak dhe zhvillimin e seminareve e trajnimeve në bashkëpunim me partnerët rajonal dhe Euro-Atlantik, për oficerët fillestarë, të nivelit të mesëm e të lartë, si dhe shërbyesve civil (Koci, 2013).

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë: bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë paraqet një mundësi tjetër për Kosovën në mbrojtjen e interesave shtetërore. Duke marrë parasysh kapacitetin dhe aftësitë operationale të FSK-së dhe kushtet strategjike të mjedisit, interesat shtetërore të “pavarësisë dhe integritetit territorial” si dhe “sigurisë dhe stabilitetit rajonal” vihen në rrezik. Bashkëpunimi konstruktiv i Kosovës me fqinjët ndihmon në ndërtimin e besimit, forcimit të marrëdhënieve të ndërsjella dhe koordinimin e reagimit ndaj kërcënimeve të përbashkëta të sigurisë. Këto aktivitete ndihmojnë në ndërtimin e mekanizmave efikas për menaxhimin e çështjeve që ndërliken me sigurinë rajonale, me synimin për të konsoliduar format e bashkëpunimit rajonal. Prandaj kjo analizë rekomandon që Qeveria duhet të vazhdojë avancimin e programeve për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë brenda rajonit, si pjesë të përpjekjeve për përmbushjen e synimit për integritet Euro-Atlantike.

Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për Kosovën zhvillohet në aktivitete të nivelit bilateral dhe multilateral rajonal dhe trans-Atlantik. Kosova tashmë ka bashkëpunim bilateral të konsiderueshëm me Turqinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kroacinë dhe Shqipërinë. Turqia ka ofruar ndihmë financiare dhe ushtarake, duke dhuruar edhe automjete të blinduara dhe helikopterë, paralel me trajnimin e oficerëve ushtarak në fushën e aviacionit dhe paqeruajtës (Mirkovic, 2013; RTK-TV, 2013; Vrajolli & Kallaba, 2012). Një marrëveshje bilaterale me Kroacinë u mundëson anëtarëve të FSK-së që të vijojnë trajnimet dhe shkollat ushtarake në Kroaci, ndërkohë që kjo e fundit mbështet Kosovën në iniciativat rajonale dhe në projektet që ndërliken me

mbrojtjen.¹³ Anëtarët e FSK-së kanë vijuar shkolla prestigjioze të NATO-s në SHBA, Britani dhe Kroaci (Koci, 2013). FSK-ja ka thelluar bashkëpunimin bilateral edhe përmes caktimit të atasheve ushtarak pranë misioneve diplomatike të Kosovës në shtetet partnere në fushën e politikës së jashtme dhe të mbrojtjes (Koci, 2013).

Këto dhe aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë i ofrojnë Kosovës mundësi për të trajnuar dhe shkolluar forcat e sigurisë bashkë me pjesëtarët e ushtrive moderne dhe me përvojë, për të përfituar nga fondet për asistencë në fushën e sigurisë që i mundësojnë FSK-së të trajnoj anëtarët e saj, të siguroj pajisje moderne si dhe të shkëmbejë atashetë ushtarak që ndihmojnë në avancimin e objektivave të politikës së jashtme dhe mbështesin përpjekjet për të mbrojtur interesat shtetërore. Efekti më i rëndësishëm që ofron bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë është progresi drejt anëtarësimit në NATO. Siç u theksua më parë, duke marrë parasysh kapacitetet dhe aftësitë operationale të kufizuara të FSK-së, anëtarësimi në aleancën e sigurisë është pothuajse i domosdoshëm në mënyrë që të siguroj mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetit territorial. Anëtarësimi jo vetëm që garanton siguri, por njëkohësisht mundëson asistencë në përmirësimin e kapaciteteve ushtarake. Në rrugëtimin e Kosovës drejt anëtarësimit në NATO duhet veçuar dy aspekte pozitive, Kartën SHBA-Adriatik dhe Programin e Partneritetit Shtetëror të Gardës Kombëtare të SHBA-ve.

Anëtarësimi i Kosovës në Kartën SHBA-Adriatik ofron një mundësi të mirë për të promovuar bashkëpunimin rajonal dhe përmirësimin e kapaciteteve të FSK-së (HINA, 2012; ATA, 2012). Ky forum është i mandatuar të lehtësoj bashkëpunimin praktik dhe të siguroj marrëveshjet e ndërsjella në mes të vendeve të rajonit në çështjet kyçe të sigurisë. Kosova duhet të vazhdoj avancimin e pozitës së saj në kuadër të Kartës SHBA-Adriatik, me qëllim që të siguroj interesin shtetëror të stabilitetit dhe sigurisë në rajon dhe realizimit të synimit për integritet Euro-Atlantike (HINA, 2012).

Pjesëmarrja e Kosovës në Programin e Partneritetit Shtetëror të Gardës Kombëtar të SHBA-ve duhet të shfrytëzohet veçanërisht gjatë procesit të

¹³ Ministri i Forcës së Sigurisë Çeku ka kërkuar nga Kroacia që të mbështes Kosovës në rrugën drejt anëtarësimit në NATO

transformimit të forcës së sigurisë. Përveç mbështetjes në fushën ushtarake, ky program ndihmon edhe në avancimin e katër interesave kyç shtetëror të Kosovës. Objektivat e programit ndihmojnë në promovimin e kapaciteteve për të planifikuar dhe përgatitur për mbrojtje të sovranitetit territorial, konsolidimin demokratik të institucioneve të shtetit, ndërtimin e kapaciteteve për të bashkëpunuar në nivel rajonal dhe në rastin e partneritetit në mes të shtetit të Iowas dhe Kosovës, promovon zhvillimin ekonomik dhe stabilitet (U.S. Departamenti i Mbrojtjes, 14 Dhjetor 2012). Kjo analizë në mënyrë të veçantë thekson rëndësinë e bashkëpunimit në kuadër të programit për të përmirësuar praktikën e kontrollit demokratik të forcave të armatosura, kapaciteteve për të planifikuar dhe zhvilluar operacione ushtarake, profesionalizimit të forcave të armatosura, ndërtimit të forcës rezervë me kosto efektive, përmirësimin e kapaciteteve për operacione të përbashkëta me shtete tjera dhe asistencën në procesin e anëtarësimit në NATO (USEUCOM, n.d.; Jansen, 2010; NGB 2012, 5 Shtator).¹⁴

Avancimi i pjesëmarrjes në Kartën SHBA-Adriatik dhe në Programin e Partneritetit Shtetëror të Gardës Kombëtar të SHBA-ve i ndihmon Kosovës që të bëjë hapa të rëndësishëm drejt anëtarësimit të Kosovës në Programin e NATO-s për Partneritetin për Paqe (PfP), dhe më vonë anëtarësimit të plotë në NATO. Programi i Partneritetit për Paqe ndihmon në “forcimin e marrëdhënieve në fushën e sigurisë në mes të partnerëve individual Euro-Atlantik dhe NATO-s” si dhe në mbështetjen e shteteve partnere në “realizimin e reformave në fushën e mbrojtjes, politikën e sigurisë dhe planifikimin, marrëdhëniet civilo-ushtarake, edukimi dhe trajnimi, bashkëpunimi në mes të ushtrive dhe manovrat e përbashkëta, planifikimi dhe reagimi ndaj emergjencave civile dhe bashkëpunimi në fushën e shkencës dhe mjedisit (NATO, 2012). Programi i Partneritetit për Paqe u ofron mundësinë shteteve anëtare që të zhvillojnë Planet e Veprimit për Partneritet Individual që ndihmojnë në avancimin e reformave të sektorit të mbrojtjes dhe sigurisë si dhe reformave sociale dhe politike të domosdoshme për integrimin Euro-Atlantik dhe garantimin e interesave shtetërore të Kosovës (NATO, 2012).

¹⁴ Edhe pse pjesëmarrja në Programin e Partneritetit Shtetëror të Gardës Kombëtar të SHBA-ve nuk paraqet ndonjë arritje në kuptim të anëtarësimit në NATO, është shndërruar në një mekanizëm të rëndësishëm për të ndihmuar vendet që aspirojnë të anëtarësohen, që të plotësojnë kushtet për anëtarësim.

10. Bibliografia

1. (2012, December 12). US-Adriatic Charter Meeting Starts In Zagreb. *HINA*.
2. (2012, December 14). Croatian, Montenegrin Ministers Meet on Fringes of US-Adriatic Charter Meeting. *HINA*.
3. (2012, November 19). Civil Protection challenges KFOR, EULEX and Police. *Koha Ditore*. pp. 1, 3.
4. (2012, October, 10). A5, 16th Conference of Adriatic Charter Holds Proceedings in Tirana. *ATA*.
5. (2013, February 20). Tensions high in north Kosovo amid EU efforts to reach deal between Kosovo and Serbia. *Associated Press*. Retrieved from <http://www.foxnews.com/world/2013/02/20/tensions-high-in-north-kosovo-amid-eu-efforts-to-reach-deal-between-kosovo-and/#ixzz2PycNzIQU>
6. (2013, February 8). Turkish defense minister in Kosovo -- Minister Yilmaz met Kosovar Security Force Minister Ceku. *Anadolu Agency*.
7. (2013, February 13). Turkey Supports Kosovo Security Force Transformation Into Army [Television broadcast]. Pristina: *Radio-Television Kosovo*.
8. (2013, March 20). Interview with U.S. Ambassador to Kosovo, Tracy Jacobson. *Armed Forces Network (AFN)*. Retrieved from <http://youtu.be/5sLgIz3qruU>
9. (2013, March 25). Greece continues to support Serbia on EU, Kosovo. *B92*. Retrieved from http://www.b92.net/eng/news/politics-article.php?yyyy=2013&mm=03&dd=25&nav_id=85354
10. Andric, G (2013). Serbs Face Phased Transition to Kosovo Rule. *Balkans Investigative Reporting Network*. Retrieved from

<http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-serbs-face-strict-transition-to-pristina-rule>

11. Barany, Z. (2012). *The Soldier and the Changing State: Building Democratic Armies in Africa, Asia, Europe, and the Americas*. Princeton, NJ: Princeton University Press.
12. Bardos, G. (2012, August 21). The Balkans: Militant Islamism's New Front. *The Jerusalem Post*. Retrieved from http://www.realclearworld.com/articles/2012/08/21/the_balkans_militant_islamisms_new_front_100199-2.html
13. Beardsley, S. (2012, December 24). Kosovo aims to form military force and join NATO. *Stars and Stripes*. Retrieved from <http://www.stripes.com/news/kosovo-aims-to-form-military-force-and-join-nato-1.201794>
14. Bernabéu, I. (2007, March) Laying the Foundations of Democracy? Reconsidering Security Sector Reform Under UN Auspices in Kosovo. *Security Dialogue*, 38(1), 71-92.
15. Bieber, F. (2003). Approaches to political violence and terrorism in Former Yugoslavia *Journal of Southern Europe and the Balkans*, 5(1), 2003, p. 40.
16. Brajshori, M. & Jovanovic, I. (2013, April 20). Historic agreement could pave way for Kosovo and Serbia. *Southeast European Times*. Retrieved from http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/04/20/feature-01
17. Brajshori, M. (2011, August 11). Kosovo hosts first regional defence ministers' conference. *Southeast European Times*. Retrieved from http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2011/11/08/feature-04
18. Brunwasser, M. (2012, February 25). Kosovo and Serbia Reach Key Deal. *New York Times*. Retrieved from

http://www.nytimes.com/2012/02/25/world/europe/25iht-kosovo25.html?_r=0

19. Bugajski, J. & Conley, H.A. (2011). *A New Transatlantic Approach for the Western Balkans*. Center for Strategic and International Studies: Washington, D.C.
20. Bytyci, F. (2011, July 20). Ethnic Serbs fire at NATO troops in Kosovo. *Reuters*. Retrieved from <http://www.reuters.com/article/2011/07/27/us-kosovo-nato-idUSTRE76Q69P20110727>
21. Central Intelligence Agency (2010). Republic of Kosovo. In *The World Factbook*. Retrieved from <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>
22. Central Intelligence Agency (2010). Republic of Montenegro. In *The World Factbook*. Retrieved from <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/mj.html>
23. Clapper, J. (2012). *Statement for the Record: Worldwide Threat Assessment of the US Intelligence Community*. Senate Select Committee on Intelligence: Washington, D.C.
24. Clapper, J. (2013). *Statement for the Record: Worldwide Threat Assessment of the US Intelligence Community*. Senate Select Committee on Intelligence: Washington, D.C.
25. Collier, P. (2007). *Post-Conflict Recovery: How Should Policies be Distinctive?* Centre for the Study of African Economies, Department of Economics, University of Oxford: Oxford, England. Retrieved from <http://users.ox.ac.uk/~econpco/research/pdfs/PostConflict-Recovery.pdf>
26. De France, O. and Witney, N. (2013, April). *Europe's Strategic Cacophony*. European Council on Foreign Relations. Retrieved from http://ecfr.eu/page/-/ECFR77_SECURITY_BRIEF_AW.pdf

27. Deliso, C. (2007). *The Coming Balkan Caliphate: The Threat of Radical Islam to Europe and the West*. Praeger Security International: Westport, CT.
28. Enthoven, A. & Smith, K.V (2005). "How Much Is Enough? Shaping the Defense Program, 1961-1969." RAND: Washington, DC.
29. European Commission (EC) (2012, October 11). Assessments of Progress of Aspiring Countries: EU Expansion -- Next Steps. *Europa*. Retrieved from <http://www.europa.eu>
30. European Union (n.d.). "EU facilitated dialogue between Kosovo and Serbia: Agreement on Regional Cooperation and IBM technical protocol." Retrieved from http://www.eu-un.europa.eu/articles/en/article_11884_en.htm
31. Forum for Security (2012, March 4). *The Control of Small Arms and Light Weapons In Kosovo: Progress and Challenges*. Retrieved from http://www.fiqfci.org/repository/docs/SALW_control_in_Kosovo_progress_and_challenges.pdf
32. Friedman, G. (2007). *Russia: Kosovo and the Asymmetry of Perceptions*. STRATFOR. http://www.stratfor.com/weekly/russia_kosovo_and_asymmetry_perceptions
33. Graduate Institute of International and Development Studies (2012). *Small Arms Survey 2012*. Geneva, Switzerland. Retrieved from <http://www.smallarmssurvey.org>
34. Grillot, S. R. (2010). Guns in the Balkans: controlling small arms and light weapons in seven Western Balkan countries. *Journal of Southeast European & Black Sea Studies*, 10(2), 147-171.
35. Heinze, H. (2013, September 4). Risk of social unrest rises in EU. *Deutsche Welle*. Retrieved from <http://dw.de/p/18CTu>

36. Hendrickson, D. (1999). "A Review of Security-Sector Reform." The Conflict, Security & Development Group Centre for Defence Studies, Kings College, University of London Strand: London. Page 9. Retrieved from <http://www.securityanddevelopment.org/pdf/work1.pdf>
37. Hoxha, A. (2012, March). *Russia's Foreign Policy in Kosovo*. e-International Relations <http://www.e-ir.info/2012/05/12/russias-foreign-policy-in-kosovo/>
38. International Institute for Strategic Studies (2012). *Strategic Survey*. London, UK, 112:1, (i)-(xx).
39. International Institute for Strategic Studies (2013). *The Military Balance*. London, UK. 113:1, 543-556.
40. Jahjaga, A. (2013, February 17). *Speech of the President of the Republic Of Kosovo*. On the Fifth Anniversary of Independence. Retrieved from <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,2774>
41. Jahjaga, A. (2013, March 23). *Speech of the President of the Republic Of Kosovo*. Forth Meeting of the National Council for European Integration. Retrieved from <http://www.president-ksgov.net/?page=2,6,2802>
42. Jansen, J. (2010). *National Guard State Partnership Program: A Whole-Of-Government Approach*. United States Army War College Strategy Research Project. U.S. Army War College: Carlisle, PA. Retrieved from <http://www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc?AD=ADA520003>
43. Karadaku, L. (2013, March 30). New extremist organizations pose a threat. *Southeast European Times*. Retrieved from http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2013/03/30/feature-01
44. Keohane, R.O. & Nye, J.S. (1977). *Power and Interdependence: World Politics in Transition* (2nd ed.). Boston, MA: Little, Brown, and Company.

45. KFOR (2005, February 08). *Press Release: Closer Cooperation with New Concept*. Retrieved from http://www.nato.int/kfor/chronicle/2005/chronicle_01/03.htm
46. Koci, M. (2012, December 25). *Ceku: 2013, Year of the Army of Kosova*. *Epoka e Re*, p 3.
47. Koci, M. (2013, January 3). *Kosovo Security Force Head Details Achievements, Future Objectives: Interview with Kosovo Security Force Commander Kadri Kastrati*. *Epoka e Re*, pp. 29, 31.
48. Kosovo Assembly, (2008). *Law on Kosovo Security Force*. Retrieved from http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L046_en.pdf
49. Krstic, B. & Bytyci, F. (2012, June 1). *Kosovo Serbs, NATO troops hurt in gun fight*. *Reuters*. Retrieved from <http://www.reuters.com/article/2012/06/01/us-kosovo-serbs-idUSBRE8500ZP20120601>
50. Linz, J. & Stepan, A. (1996). *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-communist Europe* (pp. 7-15). Baltimore, MD: Johns Hopkins University Press.
51. Lowen, M. (2011, July 27). *Kosovo tense after deadly clash on Serbian border*. *BBC News*. Retrieved from <http://www.bbc.co.uk/news/world-europe-14303165>
52. Machiavelli, N. (2001). *The Prince*. Translated by N.H. Thomson. Vol. XXXVI, Part 1. The Harvard Classics. New York: P.F. Collier & Son.
53. Marmullakaj, Q. & Peci, L. (2008). *Mapping out the Current Parliamentary Oversight of the Security Sector in Kosovo*. Kosovo Institute for Policy Research and Development. Retrieved from http://www.kipred.org/advCms/documents/21596_PARLIAMENTARY_OVERSIGHT_OF_THE_SECURITY_SECTOR.pdf

54. United Nations Security Council (2007). *The Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement*. Retrieved from http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf
55. Mearsheimer, J (2001). *The Tragedy of Great Power Politics*. W.W. Norton: New York, NY.
56. Ministry of Foreign Affairs (2013). *The Republic of Kosovo's foreign policy priorities*. Retrieved from <http://www.mfa-ks.net/?page=2,98>
57. Ministry of the Kosovo Security Forces (2012, November 20). *Press Release: Meeting on Security Strategic Sector Review of Kosovo*. Retrieved from: <http://www.mksf-ks.org/?page=2,24,652>
58. Mirkovic, D. (2013, March 4). Turkey's Intensified Political, Economic, Military Ties in Balkans Detailed. *Akter Online*.
59. NATO (2010, Dec 1). Allied Joint Publication 01(D), Allied Joint Doctrine. Retrieved from http://www.cicde.defense.gouv.fr/IMG/pdf/20101201_np_otan_ajp-01d.pdf
60. NATO (2012). *Individual Partnership Action Plans*. Retrieved from http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_49290.htm
61. NATO (2012). *The Partnership for Peace programme*. Retrieved from http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_50349.htm
62. NATO Allied Combined Operations. KFOR: Initial Tasks. Retrieved from: <http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/history/initial-tasks.aspx>
63. NATO Joint Forces Command Headquarters (JFCHQ) Naples (2011). *Press Release: KFOR reaches "Gate 2" through Deterrence Presence in Kosovo*. Retrieved from <http://www.jfcnaples.nato.int/page167501256.aspx>

64. NATO Mission in Kosovo (n.d.). *KFOR: Facts and Figures*. Retrieved from <http://www.aco.nato.int/kfor/library/facts-figures.aspx>
65. NATO Mission in Kosovo (n.d.) *KFOR Key Facts and Figures*. Retrieved from http://www.aco.nato.int/resources/site7423/General/Documents/kfor_placemat.pdf
66. NATO Mission in Bosnia i Herzegovina (2004, September). *SFOR Factsheet: Liaison and Observation Teams*. Retrieved from <http://www.nato.int/sfor/factsheet/lot/t040909a.htm>
67. Nikolla, M. (2012, November 9). Security Expert Says Kosovo Needs 'Genuine' Army To Join NATO: Interview with security expert Ramdan Qehaja. *Bota Sot*, pp. 4-5.
68. Palic, A. (2013, March 2). Balkans as Flea Market for Weaponry. *Vecernje Novosti Online*.
69. Peci, L., Dugolli, I., & Marmullakaj, Q. (2008). *The Weakest Link: Public Oversight of the Security Sector in Kosovo*. Kosovo Institute for Policy Research and Development. Retrieved from http://www.kipred.org/advCms/documents/21596_PARLIAMENTARY_OVERSIGHT_OF_THE_SECURITY_SECTOR.pdf
70. Qehaja, R., Kosumi, K., Qehaja, F., & Bekaj, A. (2012). Demobilizing and integrating a liberation army in the context of state formation: Kosovo's perspective on security transition. In Dudouet, V. (Ed.), *Post-war security Transitions: participatory peacebuilding after asymmetric conflicts* (pp. 123-138). New York. NY: Routledge.
71. Rasmussen, A.F. (2012, October 10). *Press Release: Remarks by NATO Secretary General*. Meetings of NATO Defence Ministers. Retrieved from http://www.nato.int/cps/en/natolive/opinions_90680.htm
72. Republic Of Serbia (2009, October). *National Security Strategy of the Republic Of Serbia*. Retrieved from

<http://merln.ndu.edu/whitepapers/serbianationalsecurityenglish2009.pdf>

73. Republic of Kosovo (n.d.). "Kosovo Security Force." Retrieved from <http://www.rks-gov.net/en-US/Qytetaret/Siguria/Pages/FSK.aspx>
74. Security Force's Ceku Urges Croatian Support for Kosovo's NATO Membership Path
75. Përteshi, S. (2011). *Kosovo Security Force: Between Current Challenges And Vision For The Future*. The Security Forum. Retrieved from [http://qkss.org/new/images/content/PDF/KSF%20report%20\(24.06.2011\).pdf](http://qkss.org/new/images/content/PDF/KSF%20report%20(24.06.2011).pdf)
76. Synovitz, R. & Kuzmanovski, B. (2012, April 17). Macedonia on the Brink as Leaders Try To Calm Ethnic Tensions. *Radio Free Europe/Radio Liberty*. Retrieved from http://www.rferl.org/content/macedonia_on_brink_leaders_try_to_calm_ethnic_tensions/24551399.html
77. Taylor, J. & Boggs, E. (2011). *Strategic Defense Reviews: Procedures, Frameworks, and Tools to Enhance Future Defense Institution Building Projects*. Washington, DC: Center for Strategic & International Studies.
78. The White House (2011, July). *Strategy To Combat Transnational Organized Crime*. Retrieved from http://www.whitehouse.gov/sites/default/files/Strategy_to_Combat_Transnational_Organized_Crime_July_2011.pdf
79. Tziampiris, A. (2009). Assessing Islamic terrorism in the Western Balkans: the State of the Debate. *Journal of Balkan & Near Eastern Studies*, 11(2), 209-219.
80. U.S. Department of Defense (DoD) (2010, November 8). *Capstone Concept for Joint Operations Activity Concepts*. Retrieved from http://www.dtic.mil/futurejointwarfare/concepts/ccjo_activityv1.pdf

81. U.S. DoD (2012, December 14). Department of Defense Instruction (DoDI) 5111.20: "State Partnership Program (SPP)."
82. U.S. Department of State (DoS) (2010). *Trafficking in Persons Report*. Retrieved from <http://www.state.gov/documents/organization/143187.pdf>
83. U.S. DoS (2012). *International Narcotics Control Strategy Report*. Retrieved from <http://www.state.gov/documents/organization/187109.pdf>
84. U.S. DoS (2012, September 14). *Background Note: Kosovo*. Retrieved from <http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/100931.htm>
85. U.S. European Command (USEUCOM) (n.d.). *Factsheet: National Guard State Partnership Program*. Retrieved from <http://www.eucom.mil/key-activities/partnership-programs/state-partnership-program?print=factsheet>
86. U.S. National Guard Bureau (NGB) (2011). *Factsheet: State Partnership Program*. Retrieved from <http://www.ng.mil/media/factsheets/2011/SPP%20Mar%2011.pdf>
87. U.S. NGB (2012, September 5). *State Partnership Program Draft Strategic Plan 2012-2016*.
88. United Nations (1945, June 26). *Charter of the United Nations, Chapter VII: Action With Respect To Threats To The Peace, Breaches Of The Peace, And Acts Of Aggression, Article 51*. Retrieved from <https://www.un.org/en/documents/charter/chapter7.shtml>
89. United Nations Development Program (UNDP) (2006). *Kosovo International Security Sector Review*. Retrieved from http://www.ks.undp.org/repository/docs/ISSR_report_eng_ver2.pdf
90. UNDP (2008). *Public Oversight of the Security Sector: A Handbook for Civil Society Organizations*. Retrieved from <http://www.dcaf.ch/publications/kms/index.cfm>

91. United Nations Mission in Kosovo (UNMIK) (1999, September 20). *On The Establishment Of The Kosovo Corps* (UNMIK Regulation 1999/8). Retrieved from http://www.unmikonline.org/regulations/1999/re99_08.pdf
92. United Nations Security Council (UNSC) (2007). *The Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement*. Retrieved from http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf
93. United Nations University (UNU) (2011, April 29). *Natural disasters and human security*. Retrieved from <http://unu.edu/publications/articles/natural-disasters-and-human-security.html>
94. Vrajolli, M. & Kallaba, P. (2012). *Kosovo's Path Towards the NATO Partnership for Peace Programme*. Kosovar Center for Security Studies. Retrieved from http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo's_Path_towards_the_NATO_Partnership_for_Peace_Programme_839019.PDF
95. Yarger, H. & Barber, G. (1997). *The U.S. Army War College Methodology for Determining Interests and Levels of Intensity*. Carlisle, PA: U.S. Army War College. Retrieved from <http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/army-usawc/natinte.htm>



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.